



MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS



Raport për Mbeturinat dhe Kimikatet

Prishtinë, 2014



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

Raport për Mbeturinat dhe Kimikatet

Prishtinë, 2014

Përmbajta

Parathënie	7
1. Disa karakteristika të përgjithshme për Kosovën	8
1.1. Pozita gjeografike.....	8
1.2. Relievi.....	8
1.3. Klima	8
1.4. Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë	9
1.5. Urbanizimi.....	9
2. Korniza Ligjore, strategjike dhe institucionale për mbeturina dhe kimikate	10
2.1. Ligjet dhe Udhëzimet Administrative për mbeturina dhe kimikate.....	10
2.2. Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022	11
2.3. Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017.....	12
2.4. Planet Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave	12
2.5. Direktivat e BE-së për mbeturina dhe kimikate.....	13
2.6. Struktura Institucionale	15
2.6.1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	15
2.6.2. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës – AMMK.....	15
2.6.3. Pushteti Lokal- Komunat.....	15
2.6.4. Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës- KMDM	16
2.6.5. Kompanitë rajonale të mbeturinave	16
2.6.6. Subjektet tjera.....	17
3. Gjenerimi i Mbeturinave	18
3.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale sipas regjioneve	18
3.2. Gjenerimi i mbeturinave komunale në Kosovë	23
3.3. Gjenerimi i mbeturinave industriale	25
3.4. Gjenerimi i mbeturinave të konstruktimit dhe demolimit	27
3.5. Gjenerimi i mbeturinave të veçanta	28
4. Gjendja e Deponive Sanitare	30
4.1. Deponia Sanitare në Podujevë	30
4.2. Deponia Sanitare e mbeturinave në Gjilan	31
4.3. Deponia Sanitare e mbeturinave në Prizren	31
4.4. Deponia Sanitare e mbeturinave për regjionin e Prishtinës.....	32
4.5. Deponia Sanitare e mbeturinave në Pejë.....	33
4.6. Deponia Sanitare e mbeturinave në Dragash	33
4.7. Deponia Sanitare e mbeturinave në Mitrovicë	34
4.8. Deponia Sanitare e mbeturinave në Zveçan	34
4.9. Stacioni transferues i mbeturinave për regjionin e Ferizajt	35
4.10. Stacioni transferues i mbeturinave në Drenas	35
4.11. Stacioni transferues i mbeturinave në Gjakovë.....	36
5. Deponitë ilegale të mbeturinave.....	37
6. Deponitë industriale	38
7. Kimikatet	40
7.1. Definimi dhe nocionet për kimikate dhe biocide.....	40
7.2. Prodhimi i kimikateve	40
7.3. Komunikimi i rrezikut nga kimikatet, LST dhe etiketimi	40
7.4. Eksporti dhe importi i kimikateve	43
8. Mbetjet nga kimikatet	46
8.1. Depot me mbeturinat nga kimikatet.....	46
8.2. Barnat me afat të skaduar	46
8.3. Hotspotet mjedisore nga mbeturinat dhe kimikatet.....	47

9. Trajtimi i mbeturinave dhe kimikateve	49
9.1. Riciklimi i mbeturinave.....	49
9.2. Ripërdorimi i mbeturinave në Kosovë.....	50
9.3. Trajtimi i mbeturinave spitalore	51
9.4. Djegia e mbeturinave.....	54
9.5. Trajtimi i mbeturinave te rrezikshme.....	55
10. Investimet në sektorin e mbeturinave	56
11. Ndikimet sociale dhe përfitime nga politikat e menaxhimit efikas dhe parandalimit të mbeturinave	57
12. Ndikimet në mjedis nga mbeturinat dhe kimikatet.....	58
13. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	59
13.1. Konkluzionet	59
13.2. Rekomandimet.....	59
14. Referencat dhe Burimet.....	60
15. Shtojcat	61
15.1. Shkurtesat	61
15.2. Indeksi i Tabelave.....	62
15.3. Indeksi i figurave.....	63
15.4. Harta e deponive ilegale në formatin A3	64

Parathënie

Hartimi i Raportit për gjendjen dhe menaxhimin e mbeturinave në Kosovë, është përgjegjësi dhe detyrë e AMMK-së e rregulluar sipas Ligjit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ligjit për Mbeturina. Në këtë raport janë përfshirë edhe kimikatet pasi që një pjesë e konsiderueshme e kimikateve përfundojnë si mbeturina dhe meqenëse në shumë aspekte tjera çështjet që janë të ndërlidhura janë relevante edhe për kimikate.

Qëllimi kryesor i Raportit është informimi i publikut për gjendjen e mbeturinave dhe kimikateve në Kosovës, mirëpo përmes këtij Raporti, synohet që duke informuar politik bërësit të ndikojë në përmirësimin e politikave për menaxhimin e mbeturinave dhe kimikateve. Ky Raport mundë të shërbejë edhe si një udhëzues i mirë për orientimin e projekteve dhe mbështetjes së donatorëve në sektorin e mbeturinave dhe atë të kimikateve.

Raporti përmban të dhëna për kornizën ligjore, strategjike dhe institucionale në sektorin e mbeturinave dhe kimikateve, të dhëna për gjendjen e përgjithshme të mbeturinave dhe kimikateve duke përfshirë gjenerimin e mbeturinave komunale dhe gjendjen e deponive, pastaj të dhëna për infrastrukturën, projektet dhe investimet në këtë sektor. Pjesë e rëndësishme e raportit janë edhe konkluzionet dhe rekomandimet.

Të dhënat e prezantuara në këtë Raport janë mbledhur gjatë punës në terren nga ekipet e AKMM-së, të dhëna që janë siguruar nga kompanitë publike regjionale, KMDK, ZRRUK si dhe institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Pjesë e Raportit janë edhe informata nga Ligjet, UA dhe dokumentet tjera për mbeturinat dhe kimikatet. Disa të dhëna të prezantuara në këtë Raport janë marrë edhe nga publikimet dhe raportet e ndryshme relevante.

Të dhënat e Raportit i referohen kryesisht periudhës 2009-2013, mirëpo në disa raste në mungesë të dhënave dhe për aspekte të krahasimit janë prezantuara të dhëna edhe për një periudhe të mëherëshme.

1. Disa karakteristika të përgjithshme për Kosovën

1.1. Pozita gjeografike

Kosova karakterizohet me pozitë të përshtatshme gjeografike. Shtrihet në Evropën Juglindore dhe në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik duke qenë kështu udhëkryq i rëndësishëm i gërshetimit të rrugëve transitorë që lidhin pjesë të ndryshme të Evropës dhe me gjerë që nga kohërat antike e deri me sot. Në rrjetin e rrugëve antike në Kosovë më të rëndësishmet ishin dy: ajo verilindje-jugperëndim përkatesisht Naissus (Nish)- Lissus (Lezhë) dhe veriperëndim-juglindje që lidhte Bosnjën me Scupin (Shkupin).

Pozita gjeografike fiton rëndësi të veçante pas ndërtimit të hekurudhës Selanik-Shkup- Fushë Kosovë-Mitrovicë me 1874 e cila lidhte pjesët jugore dhe veriore të Ballkanit dhe Evropës. Funkzioni transitor rritet edhe më tepër me ndërtimin e magjstrales Ferizaj-Prishtinë- Mitrovicë e cila vazhdonte përgjatë luginës së Ibrit duke krijuar lidhje të Kosovës me Evropën Qendrore dhe Perëndimore, kurse në jug përmes Grykës së Kaçanikut lidhet me pjesën e Evropës Jugore dhe "Korridorin 8", Durrës-Shkup-Sofje- Varna.

Ndërtimi i magjstrales së Adriatikut (1971) e rrit edhe më tepër karakterin transitor duke lidhur Kosovën me bregdetin e Adriatikut dhe korridorin "Dalmatin" duke e shndërruar Kosovën në një udhëkryq të rëndësishëm rajonal. Edhe ndërtimi i rrjetit të më vonshëm rrugorë dhe hekurudhorë është në funksion të rritjes së rëndësisë dhe rolit transitor të Kosovës sidomos autostrada Durrës- Morinë- Merdar.

Në aspekt politik dhe gjeo-strategjik rëndësia e pozitës gjeografike të Kosovës qëndron në faktin se Kosova është territor transitor në mes: Evropës Qendrore dhe Perëndimore me Evropës Jugore, Egjeut, Azisë Jug-Perëndimore si dhe Mediteranit Lindor të cilat në aspekt historik paraqiten si kategori të rëndësishme regjionale. Pozita gjeografike e Kosovës ka qenë e rëndësishme që nga kohërat e kaluara historike, kurse intensiteti i funksionit transitor varej nga gjendja politike dhe ekonomike.

1.2. Relievi

Format më të rëndësishme të relievit janë: fushëgropat (e Kosovës, Dukagjinit etj.), dhe malet: (Sharri, Alpet Shqiptare- Bjeshkët e Namuna, Kopauniku) etj. Malet përbëjnë 63%, kurse fushëgropat 37% të territorit të Kosovës. Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës është 810m me ekstreme në mes 270m pika më e ulët në Vërmicë dhe 2656m pika më e larta në Gjeravicë.

Në aspekt hipsimetrik sipërfaqet nën 700m përbëjnë më tepër se gjysmën e territorit (52.6%), sipërfaqet 700-1000m përbëjnë më tepër se ¼ (26.6%), kurse sipërfaqet mbi 1000m përbëjnë mbi 1/5 (20.8%) të territorit të Kosovës.

Relievi paraqet element shumë të rëndësishëm me ndikim të madh në: klimë, hidrografi, në vendosjen dhe zhvillimin e vendbanimeve etj.

1.3. Klima

Klima e Kosovës është nën ndikimin e makro faktorëve klimatik: gjerësisë gjeografike, pozita ndaj masave tokësore, ujore, pozita ndaj sistemeve barike- maksimumit të Azoreve dhe minimumit të Islandës si dhe faktorëve lokal: pozitës gjeografike, relievit dhe lartësisë mbidetare.

Duke u bazuar në makrofaktorët klimatik, Kosova karakterizohet me klimë të mesme kontinentale, mirëpo faktorët lokal ndikojnë në paraqitjen edhe të tipave tjerë klimatik.

Në varshmëri të këtyre faktorëve: pjesa lindore (rrafshi i Kosovës) karakterizohet me klimë kontinentale, kurse pjesa perëndimore (rrafshi i Dukagjinit) me klimë mesatare kontinentale me ndikim të

theksuar të klimës mesdhetare nga deti Adriatik përmes luginës së Drinit. Viset kodrinore- malore (700-1000m) si zona kalimtare karakterizohen me klimë subalpine ndërsa viset malore (mbi 1000m) karakterizohen me klimë alpine.

Temperaturat mesatare në Kosovë janë rreth 10 gradë C me temperatura minimale deri -27.2 gradë C dhe maksimale 39.2 gradë C kurse reshjet mesatare vjetore janë 596mm (IHMK 2008).

Për shkak të ndikimit të faktorëve lokal pjesa perëndimor e Kosovës karakterizohet me temperatura më të larta (mesatarja për 1 gradë C) dhe sasi mesatare të reshjeve më të larta (për afër 100mm) se sa pjesa lindore e Kosovës.

1.4. Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë

Numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës edhe për kundër shpërnguljeve dhe trysnive të shumta ndaj saj, vazhdimisht është rritur me ritme të ndryshme në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore. Gjatë periudhës 63 vjeçare (1948-2011) popullsia e Kosovës kishte një rritje prej 138.2% nga 727820 (1948) në 1733872¹.

Rritja e numrit të përgjithshëm të popullsisë ka ndikim në mjedis në shumë aspekte, prej të cilave më të rëndësishmet janë: ndikimi në shkallën e prodhimit, shfrytëzimin e resurseve natyrore, mënyrën e shfrytëzimit të tokës, krijimin e mbeturinave dhe ndotjen e mjedisit.

Lidhja në mes popullsisë dhe ndikimi në mjedis në shikim të parë është kjo: më shumë njerëz harxhojnë më shumë produkte, potencial natyror, shkaktojnë më shumë dëme dhe prodhojnë më shumë mbeturina.

1.5. Urbanizimi

Në krahasim me vitin 1948, në vitin 2004², popullsia rurale tregon rritje për 110.0%, kurse popullsia urbane tregon rritje prej 1430.8%. Sa i përket pjesëmarrjes në popullsinë e përgjithshme, popullsia urbane ka treguar rritje nga 9.7% (1948) në 46.7% (2004). Ky nivel është mjaft i diskutueshëm pasi që pjesët periferike të qyteteve të Kosovës në të shumtën e rasteve nuk ofrojnë as kushte minimale të jetës urbane.

Edhe pse mjediset urbane në disa aspekte ofrojnë përparësi në krahasim me mjediset rurale (janë më kompakte, zënë sipërfaqe më të vogël për kokë banori, kanë efikasitet në shpërndarjen e ujit, rrymës, rrugëve dhe shërbime më të mira për mbeturina etj, ndikimi i tyre negativ në mjedis është shumë më i madh në krahasim me mjediset rurale. Sidomos, ndikimi negativ në mjedis rritet me emigrimet e pa kontrolluara të cilat shfaqen përmes: rritjes së dendësisë (mbipopullimi), të viseve urbane dhe depopullimit të viseve rurale.

Po ashtu, koncentrimi i objekteve industriale në dhe pranë zonave urbane, ndërtimet pa kriter urbanistik, mungesa e infrastrukturës, vështirësitë në strehim dhe në shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, hedhja e pa kontrolluar e hedhurinave të ndërtimeve, rritja e sasisë së ujërave të zeza që përfundojnë pa trajtim në mjediset natyrore, ndikon në përkeqësimin e situatës ambientale.

Komunikacioni në mjediset urbane është shumë më i dendur dhe është burim i madh i ndotjes së mjedisit. Për pasoj gjendja e ajrit në zonat urbane është e cilësisë më të dobët se sa në zonat rurale, prej ku rrjedh edhe rëndësia e trajtimit të urbanizimit. Trendët e lëvizjes së urbanizimit tregojnë se numri i popullsisë që i është ekspozuar kushteve më të dobët ambientale është rritur vazhdimisht që pa dyshim është përcjell me rritjen e rasteve të sëmundjeve “ambientale”.

1 Rezultatet e regjistrimit të popullsisë - ESK 2011.

2 Vlerësimi i prof. A. Pushka (2004). “Statistikat vitale të kohës më të re”, Enti i Statistikave të Kosovës. Prishtinë.

2. Korniza Ligjore, strategjike dhe institucionale për mbeturina dhe kimikate

2.1. Ligjet dhe Udhëzimet Administrative për mbeturina dhe kimikate

Administrimi i mbeturinave në Kosovë rregullohet përmes Ligjit për mbeturina, (Ligji Nr. 04/L-060).

Qëllimet këtij Ligji janë: Evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, zhvillimi i qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Për plotësimin e ligjit për mbeturina janë miratuar këto udhëzime administrative:

- Udhëzimi administrativ Nr. 01/2009, për kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave.
- Udhëzimi administrativ Nr.12/2008, për asgjësimin e mbeturinave të produkteve medicinale.
- Udhëzimi administrativ Nr. 06/2008 për administrimin e mbeturinave të rrezikshme.
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale.
- Udhëzimi administrativ Nr.10/07 për administrimin e deponive të mbeturinave.
- Udhëzim administrativ Nr.02/2011 për administrimin e mbeturinave nga gypat fluoreshent që përmbajnë merkur.
- Udhëzim administrativ Nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese.
- Udhëzim administrativ Nr. 09/2009 për licenca për administrimin e mbeturinave.
- Udhëzim administrativ Nr. 07/2009 për administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest.
- Udhëzim administrativ Nr. 06/2009 për administrimin e gomave mbeturinë.
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2009 për ndëshkimet me gjobat mandatore.
- Udhëzimi administrativ Nr. 19/2012 për menaxhimin e automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre.
- Udhëzimi administrativ Nr.20/2012 për eksport, import dhe transit të mbeturinave.
- Udhëzimi administrativ Nr. 81/07 për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë.
- Udhëzimi administrativ Nr. 80/07 për mbeturinat nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar.
- Udhëzimi administrativ Nr. 39/07 për administrimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike.
- Udhëzimi administrativ Nr. 37/07 për administrimin e bifenileve dhe trefenileve të polikloruara.
- Udhëzimi administrativ Nr. 36/07 për ambalazhin dhe ambalazhet mbeturinë.
- Udhëzimi administrativ Nr. 35/07 për kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave.

- Udhëzimi administrativ Nr. 05/07 për mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi.
- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave nga industria ekstraktive dhe minierave.

Në proces të amandamentimit dhe ndryshimit janë:

- Udhëzimi administrativ Nr.10/07 për administrimin e deponive të mbeturinave.
- Udhëzimi administrativ Nr. 01/2009 për eksport,import dhe transit të mbeturinave.
- Udhëzimi administrativ Nr. 03/07 për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë.
- Udhëzim administrativ Nr. 06/2009 për administrimin e gomave mbeturinë.
- Udhëzimi administrativ Nr. 02/2009 për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinat e tyre.

Administrimi i kimikateve dhe biocideve rregullohet përmes Ligjit për kimikate, (Ligji Nr. 02/L-116) i cili është në proces të amandamentimit dhe Ligjit për Biocide (Ligji Nr. 03/L-119).

Qëllimi i Ligjit për kimikate është menaxhimi i drejtë i kimikateve të rrezikshme, mbrojtja dhe zvogëlimi i rrezikut të mundshëm nga kimikatet, të cilat mund të ndikojnë dhe shkaktojnë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Ky Ligj përcakton kushtet për vendosjen në treg të substancave dhe përzierjeve të rrezikshme si dhe përcaktimin e mënyrës së kontrollimit të tyre, vlerësimin e rreziqeve që mund të ndikojnë dëmshëm në shëndetin e njeriut dhe mjedisin, shqyrtimin dhe lëshimin e lejeve për qarkullimin.

Po ashtu përmes këtij ligji rregullohet edhe trajtimi dhe përdorimi i kimikateve, mbajtja e regjistrit të kimikateve, regjistrit të personave fizik dhe juridik që tregtojnë dhe përdorin kimikatet, kushtet për klasifikimin, etiketimin, paketimin, importin, eksportin dhe transitin e kimikateve të rrezikshme si dhe përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin dhe monitorimin e këtij Ligji.

Qëllimi kryesor i Ligjit për Produkte biocide, është që të caktojë dhe të rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdorën për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës dhe me këtë të mbrojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit.

Për plotësimin e Ligjit për Kimikate Nr. 02/L-116 janë miratuar këto udhëzimet administrative:

- Udhëzimi administrativ Nr. 222/10 - Lista Teknike e Sigurisë për Kimikate dhe mënyra e plotësimit të saj.
- Udhëzimi administrativ - Nr. 21/2012 - Notifikimi i substancave të reja.

Udhëzimi administrativ- Klasifikimi etiketimi dhe paketimi (CLP) i kimikateve të rrezikshme.

2.2. Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022

Objektivi kryesor i Strategjisë është krijimi i një kornize masash brenda së cilës në Republikën e Kosovës do të duhej të zvogëloj sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen dhe ngritjen e sistemit të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave.

Strategjia për menaxhimin e mbeturinave përcakton orientimet dhe qëllimet në fushën e menaxhimit të mbeturinave për periudhën dhjetëvjeçare 2013-2022, në harmoni me legjislacionin për menaxhimin e mbeturinave dhe mundësit ekonomike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Zhvillimin e infrastrukturës për ngritjen e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave duke krijuar kushtet për një funksionim efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;

- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave
- Përmirësimi i shërbimit të mbeturinave
- Kompletimi i legjislacionit

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme, do të zbatohen masat si në vijim:

- Përcaktimi i saktë dhe inventarizimi i mbeturinave të rrezikshme;
- Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme të trashëguara, që janë në kompetencë të Qeverisë;
- Inkurajimi i përdorimit të instrumenteve ekonomike;
- Ngritja e përgjegjësive së prodhuesit të produkteve dhe mbeturinat nga produktet.
- Inkurajimi i konsumatorit në favor të konsumit të produkteve të pastra dhe proceseve të krijimit sa më të vogël të mbeturinave.

Strategjia është dokument që dedikohet nivelit qendror dhe lokal si dhe sektorëve të ndryshëm qeveritar dhe joqeveritar duke përfshirë sektorin e ujërave, minierave, shëndetësisë, veterinarisë, planifikimit hapësinorë, ndërtimitarisë dhe industrisë etj.

Duke u nisur nga vlerësimi i situatës aktuale, si dhe vizioni për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave në vendin tonë, Strategjia ka përcaktuar objektivat dhe masat që kanë për qëllim zbatimin e tyre në menaxhimin e mbeturinave.

2.4. Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017

Qëllimi i përgjithshëm i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2013 – 2017, është përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në Republikën e Kosovës.

Objektivat kryesore në këtë plan janë:

- Forcimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave,
- Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturë,
- Ngritja e shkallës së vetëdijes, ndërgjegjësimit dhe informacionit për menaxhimin e mbeturinave.

Në Planin për Menaxhimin e Mbeturinave përcaktohen projektet në fushën e menaxhimit të mbeturinave për periudhën pesëvjeçare (2013-2017), në harmoni me Strategjinë për Menaxhimin e mbeturinave dhe mundësitë ekonomike.

2.5. Planet Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave

Po ashtu janë hartuar edhe 14 Plane lokale për menaxhimin e mbeturinave, konform kërkesave të Ligjit për mbeturina.

Komunat që kanë hartuar Plane Lokale për menaxhimin e mbeturinave janë: Prishtina, Prizreni, Hani i Elezit, Vitia, Deçani, Juniku, Peja, Malisheva, Gracanica, Kllokoti, Ranillugu, Parteshi, Novobrdë dhe Kamenica.

Ndërsa në komunat Mitrovicë, Rahovec, Fushë Kosovë dhe Istog, hartimi i Planeve Lokale për menaxhimin e mbeturinave është në proces.

2.6. Direktivat e BE-së për mbeturina dhe kimikate

Në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, administrimi i mbeturinave është i rregulluar përmes disa direktivave.

- Direktiva kornizë mbi mbeturinat 75/442/EEC & Direktiva kornizë e amendamentuar mbi mbeturinat 91/156/EEC
- Direktiva për mbeturinat e rrezikshme (Direktiva 91/689/EEC)
- Direktiva për vajrat e përdorura (Direktiva 75/439/EEC)
- Direktiva për deponitë e mbeturinave 99/31/EC
- Direktiva për llumin e ujërave të zeza (Direktiva 86/278/EEC)
- Direktiva për incinerimin e mbeturinave 2000/76/EC
- Direktiva për veturat që kanë arritur fundin e jetëgjatësisë 2000/53/EC
- Draft direktiva për mbeturinat e pajisjeve elektronike dhe elektrike
- Rregullorja për transportin e mbeturinave 259/93/EEC
- Direktiva për ambalazhet mbeturinë 94/137/EEC
- Direktiva për kontrollin dhe parandalimin e ndotjes së integruar EEC/96/61.

Direktiva kornizë për mbeturinat- përcakton kërkesat themelore për trajtimin e mbeturinave dhe përcakton se çfarë nënkuptohet me "mbeturina".

Ajo parashikon që Shtetet Anëtare të BE duhet:

- Të sigurojnë që deponimi dhe përpunimi i mbeturinave nuk paraqesin rrezik për ujin, ajrin, tokën, bimët dhe kafshët.
- Të mos lejojnë deponimin e mbeturinave të përbëjnë një shqetësim publike përmes niveleve të zhurmës të tepërt, të erërave të pakëndshme, apo të degradimit të vendeve me interes të veçantë natyror.
- Të ndalojnë shkarkimin ose deponimin e pakontrolluar të mbeturinave.
- Të krijojnë një rrjet të integruar dhe efektiv të impianteve për deponimin e mbeturinave, të përgatisin plane për menaxhim të mbeturinave, të sigurojnë që ata të cilët deponojnë mbeturinat ti trajtojnë ato si duhet, dhe të sigurojnë që operatorët e trajtimit të mbeturinave të jenë të licencuar.
- Të kërkojnë që mbledhësit e mbeturinave të kenë autorizime të veçanta dhe të mbajnë shënime.
- Të kryejnë inspektime të kompanive të përfshira në deponimin ose mbledhjen e mbeturinave.

Direktiva për mbeturinat e rrezikshme- definon mbeturinat e rrezikshme dhe përcakton rregulla për trajtimin e tyre.

Direktiva PCB/PCT- merret me deponimin e kimikateve të caktuara të rrezikshme të cilat përfaqësojnë një kërcënim të veçantë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Kjo direktivë obligon të gjitha kompanitë e përfshira në dekontaminimin ose deponimin e PCB-ve, apo kompanitë që përdorin PCB ose pajisjet e tyre përmbajnë këtë kimikat, së pari të marrin leje. Direktiva përcakton kërkesat në lidhje me dekontaminimin apo deponimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe asgjësimin e PCB-ve të përdorura në mënyrë që të sigurohet që ato janë eliminuar plotësisht.

Direktiva për deponitë e mbeturinave- përcakton rregulla të detajuara mbi deponitë e mbeturinave. Kjo direktivë obligon operatorët e deponive ekzistuese të kenë një plan operativ të miratuar, i cili

tregon se si kërkesat e Direktivës do të përmbushën brenda afatit kohor të kërkuar. Këto plane duhet të ndihmojnë për të parandaluar efektet negative të deponive në ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, tokë dhe ajër. Direktiva gjithashtu ndalon lloje të caktuara të mbeturinave në deponi, për shembull gomat e përdorura, dhe kërkon nga shtetet anëtare të reduktojnë sasinë e mbeturinave të biodegrueshme që deponojnë në 35% nga 1995 nivele.

Direktiva për llumin e ujërave të zeza- synon mbrojtjen e mjedisit dhe në veçanti të tokës, kur llumi i ujërave të zeza përdoret në bujqësi dhe përcakton kontrolle mbi përdorimin e llumit të ujërave të zeza në bujqësi.

Direktiva për incinerimin e mbeturinave- ka për qëllim të parandalojë ose të limitoj efektet negative të incinerimit të mbeturinave. Ajo imponon kërkesat operative dhe teknike dhe përcakton vlerat limituese të emërtimeve për impiantet për incinerimin dhe bashke incinerim brenda BE-së.

Direktiva për vajrat e përdorura- synon të krijojë një sistem të harmonizuar për mbledhjen, trajtimin, ruajtjen dhe asgjësimin e vajrave, të tilla si vajra lubrifikante për automjete.

Direktiva për ambalazhet mbeturinë - përcakton objektivat për rimëkëmbjen dhe riciklimin e ambalazheve mbeturinë dhe kërkon nga shtetet anëtare që të themelojnë skema për mbledhjen, riciklim dhe ripërdorimin e mbeturinave të tilla.

Direktiva për veturat që kanë arritur fundin e jetëgjatësisë - përcakton masat që synojnë parandalimin e mbeturinave nga automjetet motorike dhe komponentëve të automjeteve që kanë arritur fundin e ciklit të jetës së tyre dhe promovon ripërdorimin, riciklimin dhe format tjera të ripërdorimit të automjeteve.

Direktiva kërkon që sistemet e grumbullimit të jenë të themeluara në atë mënyrë që të sigurojnë që veturat që kanë arritur fundin e jetëgjatësisë të jenë të deponuara në mënyrë efektive dhe të sigurt, pa dëmtuar mjedisin.

Direktiva për mbeturinat e pajisjeve elektronike dhe elektrike (WEEE)- ka për qëllim të parandalojë gjenerimin e mbeturinave elektrike dhe elektronike si dhe për të promovuar ripërdorimin, riciklimin dhe forma të tjera të rimëkëmbjes në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave të tilla për tu eliminuar nëpërmjet deponimit apo incinerimit. Ajo kërkon mbledhjen e pajisjeve elektronike dhe elektrike, riciklimin dhe ripërdorimin e tyre.

Direktiva për kufizimin e përdorimit të substancave të caktuara të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike- Direktiva RoHS - 2002/95/EC ka për qëllim të zvogëlojë ose eliminojë substanca të caktuara në prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike në mënyrë që të ndihmojë menaxhimin e mbeturinave.

Direktivat për kimikate- Në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, administrimi i Kimikateve është i rregulluar përmes këtyre direktivat dhe rregulloreve kryesore:

- Direktiva 67/548/EEC për substancat e rrezikshme
- Direktiva 1999/45/EC për preparatet e rrezikshme
- Direktiva 2004/9/EC për inspektimin dhe verifikimin e praktikave të mira laboratorike (GLP).
- Rregullore (EC) 1272/2008 për Klasifikim etiketim dhe paketim të substancave të rrezikshme – e cila i ndryshon direktivat e mësipërme për substanca deri në dhjetor 2010 dhe -për përzierjet (preparatet) kimike deri në vitin 2015.
- Rregullore (EC) 1907/2006– REACH për Regjistrim, Vlerësim, Autorizim dhe Kufizim të kimikateve.
- Rregullore (EC) 689/2008 për eksport-import të kimikateve të rrezikshme.
- Rregullore (EC) 648/2004 për detergjentet.
- Si dhe përmes katalogëve evropianë të lëndëve të rrezikshme (EINECS, ELINCS, CAS).

2.7. Struktura Institucionale

2.7.1 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Në fushën e administrimit të mbeturinave sipas Ligjit për Mbeturinat, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ka këto kompetenca:

- Përcaktimi i politikave të përgjithshme për mbeturinat,
- Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave dhe e sektorit për menaxhimin e mbeturinave,
- Hartimi i Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planit të Veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe zbatimin e tyre,
- Lëshimin e licencës për menaxhimin e mbeturinave dhe mbajtja e evidencës në regjistrin për licencë
- Dhënia e lejeve për import, eksport dhe kalim transit të mbeturinave;
- Zbatimi i marrëveshjeve në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar për menaxhimin e mbeturinave;

Me hyrje në fuqi të Ligjit të ri për Mbeturina (Nr.04/L-060), në bazë të nenit 82 dhe 83 të këtij ligji, MMPH-së i janë bartur edhe kompetencat që më parë kanë qenë në përgjegjësi të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim-ZRRUK.

2.7.2. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës - AMMK

AMMK si institucion ekzekutiv mjedisor kryen këto detyra dhe përgjegjësi në administrimin e mbeturinave:

- Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për mbeturinat
- Krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për mbeturina,
- Hartimin e raporteve për gjendjen dhe menaxhimin e mbeturinave,
- Monitorimin e gjendjes së deponive sanitare, regjionale dhe lokale,
- Krijon bazën e shënimeve dhe sistemin informativ për administrimin e mbeturinave;
- Parashikon dhe paralajmëron mbi zhvillimet dhe efektet që ndërlidhen me mbeturinat.

2.7.3. Pushteti Lokal- Komunitat

Komunitat si institucione lokale në administrimin e mbeturinave kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- Krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre,
- Hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij;
- Hartimin e raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës përkatëse dhe përkujdesja për sistemin e informimit të publikut,
- Rregullimi i përgjegjësive dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimi i tyre organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
- Përzgjedh personat e licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre;

- Cakton tarifat dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale.
- Evidentimi i vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimi i projekteve për sanimin e tyre me shënime për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve.

2.7.4. Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës- KMDM

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës Sh.A. (ish KLMC), është ndërmarrje publike qendrore, për menaxhimin e Deponive Sanitare të Mbeturinave në Republikën e Kosovës. Aktivitetet primar i kësaj kompanie është menaxhimi i deponive Sanitare të Mbeturinave të Ngurta Komunale në Kosovë.

E themeluar në dhjetori 2005, KMDK SH. A. fillimisht ka qenë në përgjegjësi të UNMIK-ut dhe i ka dhënë llogari AKM-së. Me aprovimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Nr. 03/L-087) në qershor të vitit 2008 përgjegjësia e KMDK SH. A. është transferuar nga UNMIK-u tek Qeveria e Republikës së Kosovës (MZHE).

Kompania për Menaxhimin e Deponive Sanitare të Kosovës shërbimet e veta i ofron në këto deponi të Kosovës:

- Deponia Sanitare e Prishtinës
- Deponia Sanitare e Podujevës
- Deponia Sanitare e Prizrenit
- Deponia Sanitare e Gjilan
- Statcioni i Transferit në Ferizaj

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë është përgjegjëse për Menaxhimin e Deponive Sanitare Regjionale të mbeturinave të ngurta komunale të lartë cekura. Ndërsa deponitë e mbeturinave komunale në Mitrovicë dhe Pejë, menaxhohen nga ndërmarrjet publike regjionale të qytetit të Mitrovicës dhe Pejës.

2.7.5. Kompanite rajonale të mbeturinave

Kompanitë Rajonale të mbeturinave e kanë statusin e ndërmarrjeve publike rajonale dhe aktiviteti kryesor i tyre është kryerja e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave dhe dorëzimin e tyre në deponitë sanitare.

Sipas ligjit për ndërmarrjet publike në këtë kategori të ndërmarrjeve bëjnë pjesë:

- Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi sh.a, Prishtinë;
- Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti sh.a, Pejë;
- Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastërtia sh.a, Ferizaj;
- Kompania Rajonale e Mbeturinave Eco-Regjioni sh.a, Prizren;
- Kompania Rajonale e Mbeturinave EkoHigjiena sh.a, Gjilan;
- Kompania Rajonale e Mbeturinave Uniteti sh.a, Mitrovicë;
- Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabratit sh.a Gjakovë;
- Kompania Rajonale e Mbeturinave Standard, Mitrovicë,
- Kompania e Mbeturinave Zveçan, Zveçan,
- Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturinave Ibri, Zubin Potok,
- Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturinave 24 Nëntori, Leposaviq

Të gjitha ndërmarrjet e radhitura në këtë listë janë në pronësi të komunës ose komunave dhe përqindja e pronësisë së secilës komunë do të jetë siç është përcaktuar në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

2.7.6. Subjektet tjera

Në ligjin për mbeturinat janë të përcaktuara detyrimet dhe përgjegjësitë edhe për subjekteve tjera publike ose private që merren me menaxhimin e mbeturinave duke përfshirë këtu:

- Zotëruesit e mbeturinave
- Importuesit e mbeturinave
- Prodhuesit e mbeturinave
- Transportuesit e mbeturinave
- Operatorëve që merren me trajtimin e mbeturinave
- Operatorëve që merren me grumbullimin e mbeturinave dhe
- Operatorëve që merren me deponimin e mbeturinave

Të gjitha këto subjekte obligohen që të pajisen me licencë për veprimtarinë e tyre, të hartojnë plane për menaxhimin e mbeturinave, të mbajnë evidenca për veprimtaritë e tyre, të raportojnë rregullisht në organet kompetente, si dhe ti përmbahen ligjeve në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

3. Gjenerimi i Mbeturinave

3.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale sipas regjioneve

Të dhënat e prezantuara në tabelat 1, 2, 3, 4 dhe 5 tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2009, është deponuar në deponinë e Prishtinës (84,660.59 ton), ndërsa sasia më e vogël është grumbulluar në deponinë e Sharrit (4807.00 ton). Kjo vlen edhe për vitin 2010 ku, sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara është në deponinë e Prishtinës (83,742.23 ton), ndërsa sasia më e vogël është deponuar në deponinë e Sharrit (5081.7 ton). Në vitin 2011 sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara përsëri është në deponinë e Prishtinës (81,816.63 ton) ndërsa sasia më e vogël është deponuar në deponinë sanitare të Sharrit (5248.00 ton). Situata është e ngjashme edhe për vitet 2012 dhe 2013 ku sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare të Prishtinës (78,393.54 ton gjegjësisht 89,806.18 ton) ndërsa më e vogël në Sharr (4,530.00 ton gjegjësisht 5,161.50 ton).




Fig. 1. Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare 2009-2013

Nëse i krahasojmë të dhënat për mbeturinat e deponuar në deponitë sanitare për vitet 2009, deri në vitin 2013 vërehet se në të gjitha deponitë regjionale dhe komunale ka pasur sasi më të mëdha të deponimit të mbeturinave. Sasia e gjenerimit të mbeturinave ka qenë më e madhe gjatë vitit 2013.




Fig.2. : Sasia e grumbullimit të mbeturinave sipas regjioneve 2009-2013

Në vitin 2012 vërehet një rënie në grumbullimin dhe deponim e mbeturinave. Dy mundë të jenë faktorët të cilët kanë dikuar në renin e sasisë së mbeturinave të grumbulluar: Rritja e sasisë së mbeturinave të ricikluara dhe rritja e efikasitetit të deponimit të mbeturinave në deponi sanitare nga kompanitë për grumbullimin e mbeturinave.




Tabela 1. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2009 të shprehura në ton³

2009	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Pristinë*	6,967.45	6,060.84	7,794.76	8,539.91	8,299.89	8,588.45	4,383.72	6,335.95	7,264.75	7,831.62	5,206.45	7,386.80	84,660.59
2	Gjilan*	3,642.26	3,236.29	3,604.45	4,537.04	4,582.66	4,336.01	2,392.61	4,488.12	2,552.47	2,513.01	4,129.69	2,551.62	42,566.23
3	Prizren*	2,705.50	2,543.73	3,088.40	3,836.50	3,520.25	3,377.93	1,968.20	4,267.22	4,553.70	1,691.30	3,672.67	3,402.00	38,627.40
4	Podujevë*	360.33	358.84	463.06	610.02	509.86	503.32 T	353.05	448.96	496.45	589.86	589.17	618.93	5,398.53
6	Pejë**	1677	1480	1820	1899	1823	1930	2250	2370	2160	2040	1855	1873	23177
7	Sharr	314	296	331	415	426	366	534	573	450	419	359	324	4807.00
8	Mitrovicë**	2,302.64	1,927.15	2,888.88	3,308.14	3,045.8	3,031.27	3,378.98	2,903.9	3,014.58	3,099.68	2741.01	2,553.79	34,195.82
9	Ferizaj*	1,069.39	1,250.90	1,002.60	1,732.20	1,411.50	609.30	710.30	285.29	1,845.17	1,895.93	991.75	969.75	13,774.08
	Totali	19,038.57	17,153.75	20,993.15	24,877.81	23,618.96	22,238.96	15,970.86	21,672.44	22,337.12	20,080.40	19,544.7	19,679.8	247,206.65

Tabela 2. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2010 të shprehura në ton⁴

2010	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Pristinë*	6,423.75	6,326.54	6,852.50	6,395.38	6,706.95	6,330.10	7,063.85	7,331.98	7,508.48	7,826.96	8,077.71	6,898.03	83,742.23
2	Gjilan*	2,093.95	2,231.51	3,070.35	3,695.06	3,176.08	2,577.95	3,658.85	3,088.35	2,716.37	2,573.78	2,260.79	1,951.08	33,094.12
3	Prizren*	2,855.10	2,772.46	3,507.78	3,912.80	3,966.40	4,067.30	4,645.91	5,380.65	5,098.00	5,538.78	5,958.34	4,685.90	52,389.42
4	Podujevë*	513.60	407.97	18.80	1,355.10	26.95	2,507.72	38.11	40.49	44.05	567.01	594.01	510.80	6,624.61
6	Pejë**	1,662	1,395	1,400	2,226	2,177	2,168	2,168	2,756	2,440	2,178	2,202	1,884	24,656
7	Sharr	282.5	292	301.2	415	408	409	457	628	628	420	421	420	5081.7
8	Mitrovicë**	2,275	2,307	2,992	2,707	2,708	2,763	3,502	3,555	3,950	3,569	3,231	2,909	36,469
9	Ferizaj*	988.75	357.90	643.10	667.40	569.10	1,294.59	1,061.55	1,672.30	1,608.00	1,608.60	1,496.50	1,521.40	13,489.19
	Totali	17,094.65	16,090.38	18,785.73	21,373.74	19,738.48	22,117.66	22,595.27	24,452.77	23,992.90	24,282.13	24,241.35	20,780.21	255,546.27

3 KDMK dhe ZRRUK, 2008

4 KDMK dhe ZRRUK, 2010

Tabela 3. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2011 të shprehura në ton⁵

2011	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	6,129.63	5,503.53	6,663.36	6,898.88	6,868.26	6,811.13	7,111.31	7,293.80	7,572.41	7,090.16	6,845.34	7,028.82	81,816.63
2	Gjilan*	1,690.72	1,651.22	2,811.63	2,531.37	2,687.38	2,857.74	3,196.94	3,646.87	3,440.74	3,100.12	2,658.29	2,663.49	32,936.51
3	Prizren*	4,517.30	4,015.60	4,994.20	5,086.26	5,812.93	5,544.70	6,135.50	7,035.70	6,290.30	5,946.53	5,112.50	4,571.40	65,062.92
4	Podujevë*	399.89	391.09	903.84	522.36	651.86	345.00	648.98	691.07	711.45	698.47	602.11	548.99	7,115.11
6	Pejë**	1,427	1,316	1,763	2,182	2,128	2,152	2,117	2,398	2,075	2,099	1,853	1,740	23,250.00
7	Sharr	303	312	320	426	435	435	459	631	640	426	435	426	5,248.00
8	Mitrovicë**	2,416.22	2,213.39	3,161.5	3,122.78	3,196.14	3,724.74	3,776.18	3,756.65	3,344.42	2,903.31	2,520.9	2,425.74	36,561.97
9	Ferizaj*	1,348.40	1,185.60	981.85	1,257.79	1,497.20	1,651.74	1,886.45	1,966.70	1,954.50	1,831.80	1,701.00	1,533.90	18,796.93
	Totali	18,232.16	16,588.43	21,599.38	22,027.44	23,276.77	23,522.05	25,331.36	27,419.79	26,028.82	24,095.39	21,728.14	20,938.34	270,788.07

Tabela 4. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2012 të shprehura në ton⁶

2012	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	5,287.08	5,096.30	7,592.91	6,757.77	6,371.67	6,895.66	6,996.11	7,614.35	7,097.02	6,832.30	6,092.71	5,759.66	78,393.54
2	Gjilan*	1,967.35	1,933.20	2,949.51	2,455.28	2,948.26	1,968.33	1,850.30	3,324.31	2,710.95	3,517.97	3,520.11	2,608.01	31,753.58
3	Prizren*	4,047.20	3,246.60	6,207.46	5,378.50	6,198.80	5,070.90	5,298.30	6,950.20	5,456.00	5,245.90	5,210.70	3,438.60	61,749.16
4	Podujevë*	489.20	377.00	650.34	551.40	1,166.70	652.55	581.75	644.70	674.00	701.30	540.70	498.45	7,528.09
6	Pejë**	2,122.00	1,189.00	2,847.00	2,472.00	3,138.00	2,754.00	2,948.00	3,855.00	2,921.00	3,121.00	2,785.00	2,471.00	32,623.00
7	Sharr	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	377.5	4,530.00
8	Mitrovicë**	2,296.87	1,847.29	3,255.76	2,839.98	3,162.07	2,562.78	3,052.78	2,804.41	3,133.40	3,133.40	2,687.63	2,536.51	33,458.20
9	Ferizaj*	1,326.60	947.48	2,143.78	1,759.03	1,703.60	983.40	478.10	719.10	795.30	1,459.09	1,096.23	861.80	14,273.51
	Totali	17,913.8	15,014.37	26,024.26	22,591.46	25,066.6	21,265.12	21,582.84	26,763.69	22,836.18	24,388.46	22,310.58	18,551.53	264,309.08

5 KDMK dhe ZRRUK, 2011

6 KDMK dhe KRM-te , 2012

Tabela 5. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2013 të shprehura në ton?

2013	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	5,878.35	6,504.57	6,865.15	7,462.23	7,676.87	6,860.37	8,325.22	8,473.64	8,139.62	8,883.08	7,278.74	7,458.34	89,806.18
2	Gjilan*	2,670.06	2,077.28	2,312.96	3,328.71	3,262.98	2,903.36	3,686.62	3,740.17	3,593.70	3,570.70	2,700.03	2,531.89	36,378.46
3	Prizren*	3,891.50	3,158.40	3,875.74	4,922.90	5,252.60	4,076.50	4,456.30	6,075.61	5,867.20	6,724.34	5,510.80	5,182.60	58,994.49
4	Podujevë*	518.5	481.8	504.3	581.5	619.03	291.03	790.24	822.2	786.97	861.9	781.52	819.1	7,858.09
6	Pejë**	2691	2255	2710	3040	2888	2661	3542	3873	3324	3638	2934	2919	36,475.00
7	Sharr	357.7	302.8	361.1	402.4	434.2	403.6	495.3	738.7	464.1	522.9	310.4	368.3	5,161.50
8	Mitrovicë**	2479.73	2146.52	2550.46	3270.46	3153.71	2945.03	3363.55	3496.61	3,117.84	3528.15	2965.42	3163.13	36,190.61
9	Ferizaj*	974.8	932.5	1,312.10	1,043.50	1,271.60	908.7	1,446.23	1,454.24	1,283.57	1,407.17	1,103.80	1,207.05	14,345.26
	Totali	19,461.64	17,858.87	20,501.81	24,051.70	24,558.99	21,049.59	26,105.46	28,674.17	26,577.00	29,136.24	23,584.71	23,649.41	285,209.59

3.2. Gjenerimi i mbeturinave komunale në Kosovë

Sasia e mbeturinave të gjeneruara për person në Kosovë për vitin 2008 është 167 kg, për vitin 2009 është 193 kg, për vitin 2010 është 297 kg ndërsa për vitin 2011 është 335 kg dhe në vitin 2012 është 334 kg. Këto të dhëna tregojnë për një rritje të ndjeshme të sasisë së mbeturinave për kokë/banori. Krahasuar me regjionet tjera sasi më e madhe vjetore e mbeturinave për person gjenerohet në regjionin e Prishtinës.

Mesatarja ditore e mbeturinave të gjeneruara për person në Prishtinë për vitin 2008 është 0.9 kg, për 2009 është 1.2 kg, për vitin 2010 është 1.4 kg, për vitin 2011 është 1.3 kg dhe për vitin 2012 është 1.4 kg. Ndërsa në regjionet tjera mesatarja ditore e mbeturinave të gjeneruara për vitin 2008 dhe 2009 është 0.3 kg në, për vitin 2010 është 0.6 kg, për vitin 2011 është 0.8 kg dhe për vitin 2012 është 0.7 kg. (Tabela 6).

Tabela 6. Sasia mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë për banorë (kg/vit dhe kg/ditë) për 2008- 2012⁸

Vendi i grumbullimit	2008			2009			2010			2011			2012		
	Sasia e Grumbulluar	Mbeturina	Mbeturina / banorë / ditë	Sasia e Grumbulluar	Mbeturinat	Mbeturina / banorë / ditë	Sasia e Grumbulluar	Mbeturinat	Mbeturina / banorë / ditë	Sasia e Grumbulluar	Mbeturina	Mbeturina / banorë / ditë	Sasia e Grumbulluar	Mbeturina	Mbeturina / banorë / ditë
Njësia	1000/Ton	Kg/Banorë		1000/Ton	Kg/Banorë		1000/Ton	Kg/Banorë		1000/Ton	Kg/Banorë		1000/Ton	Kg/Banorë	
Prishtina dhe regjioni	198	396	0.9	218	436	1.2	222	511	1.4	230	488	1.3	248	515	1.4
Regjionet tjera në Kosovë	153	95	0.3	187	117	0.3	293	223	0.6	352	278	0.8	352	269	0.7
Kosova Gjithsej	351	167	0.5	405	193	0.5	515	297	0.8	582	335	0.9	606	334	0.9

Të dhënat e prezantuara në figurat 3, 4 dhe 5, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave grumbullohet sipas shërbimit “derë me derë”, ndërkohë që sipas shërbimit për banesa kolektive ky grumbullim është më i vogël. Ky dallim në mes të sasisë së mbeturinave të grumbulluara sipas shërbimit “derë me derë” dhe atij për banesa kolektive është me pak i shprehur në regjionet tjera të Kosovës, krahasuar me regjionin e Prishtinës.

⁸ Anketa e mbeturinave komunale 2011, ASK




Fig.3: % e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit në nivel të Kosovës

Në Kosovë grumbullimi i mbeturinave derë më derë ishte 58 % ndërsa në banimin kolektiv 42 %.




Fig.4: Përqindja (%) e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit në Prishtinë dhe region




Fig.5: Përqindja (%) e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit sipas regjioneve tjera të Kosovës

Në regjionet tjera në Kosovë grumbullimi i mbeturinave komunale ishte në raport 41 % në banim kolektiv dhe 59 % në banim derë më derë. Ndërsa në regjionin e Prishtinës 42% në banim kolektiv dhe 58% derë me derë.

Figura 6 tregon strukturën sipas llojeve të mbeturinave në nivel të Kosovës. Sasia e tyre është kalkuluar duke u bazuar në hulumtimet që janë bërë në 4 qytet të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Viti dhe Hani i Elezit. Hulumtimet janë pjesë e planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave të përkrahura nga GIZ, JICA dhe LOGOS.




Fig.6: Përqindja (%) e mbeturinave sipas llojit 2012




Fig.7: Përqindja (%) e mbeturinave sipas llojeve në Kosovë 2008 (%)⁹

Në tabelën 7 është paraqitur struktura sipas llojeve të mbeturinave në katër qytetet ku janë zhvilluar planet komunale për menaxhimin e mbeturinave: Prishtinë, Prizren, Viti dhe Hani i Elezit. Nëse e krahasojmë strukturën sipas llojeve të mbeturinave në Prishtinë në vitin 2003 dhe në vitin 2012, atëherë shihet qartë se struktura sipas llojeve të mbeturinave ka ndërruar mjaft (figura 7).

Tabela 7: Përqindja (%) e mbeturinave sipas llojeve në Prishtinë, Prizren, Viti dhe Hani i Elezit¹⁰

Nr		Prishtinë %	Prizren %	Viti %	Hani i Elezit %
1	Biodegraduese	41.00	41.00	49.50	35.78
2	Druri	1.20	3.00	9.90	14.80
3	Letër\Karton	12.80	13	4.36	4.11
4	Plastikë	14.80	10.70	9.90	9.37
5	Qelq	4.50	4.60	8.54	11.82
6	Tekstil	3.50	1.20	8.89	13.51
7	Metal	1.20	1.30	8.49	11.14
8	Mbet. të rrezikshme	0.40		0.35	0.09
9	Inerte	7.20			
11	Tjera	7.60	12.80		

3.3 Gjenerrimi i mbeturinave industriale

Sipas një anketimi të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2010 sasia e mbeturinave industriale është 580,154 ton ku 36,241 ton (Fig.8) prej tyre janë mbeturina të rrezikshme ndërsa pjesa tjetër janë mbeturina jo të rrezikshme.

⁹ Raporti Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AMMK

¹⁰ Planet komunale për menaxhimin e mbeturinave.




Fig. 8: Përqindja (%) e mbeturinave industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme¹¹.

Në vijim janë të paraqitur disa të dhëna për sasinë e mbeturinave industriale nga bizneset me shtatë ose më shumë punëtorë dhe ato me më pak se shtatë punëtorë.

Sipas të dhënave sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruara është në sektorin e prodhimeve të ushqimit dhe pijeve, 49% të industrisë me më shumë se shtatë punëtor respektivisht 69% të industrisë me më pak se shtatë punëtor (Tabelat 7 dhe 8).

Në bazë të këtyre tabelave shihet se sasi e madhe e mbeturinave vjen edhe nga sektori i minierave. Duhet potencuar se sektori i minierave gjenerojnë kryesisht sasi më të madhe të mbeturinave të rrezikshme.

Tabela 8: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me shtatë ose më shumë punëtorë¹²

Grupi	Lloji i industrisë	Mbeturinat jo të rrezikshme në Ton	Mbeturinat të rrezikshme në Ton
14	Miniera dhe gurorë tjera	172.686	35.500
15-16	Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve / Prodhimi i produkteve të duhanit	297.173	550
17-19	Tanimi ose mbulesat nga lëkura; prodhimi valixhes, çanta dore, takëme, parzmore dhe këpucë	297	-
20-22	Botimi, shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara	445	85
23-25	Prodhimi i gomës dhe prodhimeve plastike	3451	-
26	Prodhimi i produkteve të tjera jometalike minerale	94.490	34
27-29	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve n.e.c	415	-
30-35	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit	-	-
36	Prodhimi i mobiljeve, prodhimi n.e.c	47	30
37	Reciklimi	15.326	-
40	Furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ujë të nxehtë	11	-
41	Mbledhja, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	244	-
Total		566.666	36.199

¹¹ Anketa e mbeturinave industrial 2010, ESK

¹² Anketa e mbeturinave industriale 2010, ESK

Tabela 9: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me më pak se shtatë punëtorë¹³.

Grupi	Lloji i industrisë	Mbeturinat jo të rrezikshme në Ton	Mbeturinat të rrezikshme në Ton
14	Miniera dhe gurora tjera	2.654	1.0
15-16	Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve / Prodhimi i produkteve të duhanit	9.403	-
17-19	Tanimi ose mbulesat nga lëkura; prodhimi valixhes, çanta dore, takëme, parzmore dhe këpucë	211	-
20-22	Botimi, shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara	37	-
23-25	Prodhimi i gomës dhe prodhimeve plastike	45	0.3
26	Prodhimi i produkteve të tjera jometalike minerale	344	-
27-29	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve n.e.c	16	0.2
30-35	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit	352	-
36	Prodhimi i mobileve, prodhimi n.e.c	265	-
37	Riciklimi	226	40.0
40	Furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ujë të nxehtë	-	-
41	Mbledhja, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	-	-
Total		13.588	41.5

Sasia totale e mbeturinave industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të gjeneruar në ton është 616,395 ton ku rreth 66% prej tyre trajtohen (Tabela 9).

Tabela 10: Sasia e mbeturinave të gjeneruara, të mbeturinave të rrezikshme dhe të trajtuara¹⁴

Lloji i industrisë	Mbeturinat e gjeneruara në ton	Mbeturinat e gjeneruara të rrezikshme në ton	Mbeturinat të trajtuara në ton
C, D dhe E	580,145	36,241	383,323

3.4 Gjenerimi i mbeturinave të konstruktimit dhe demolimit

AMMK nuk ka të dhëna relevante për sasinë e mbeturinave të ndërtimit. Po ashtu në Kosovë ende nuk është ndërtuar asnjë deponi për grumbullimin e këtij lloji të mbeturinave. Nuk ka të dhëna as për sasinë e mbeturinave nga demolimi dhe konstruktimi që riciklohen. Hedhja dhe grumbullimi i tyre ende nuk është e rregulluar. Kjo po ndikon edhe më tej në përkeqësimin e gjendjes në sektorin e mbeturinave. Sidomos është shqetësuese dukuria e zënies së sipërfaqeve të tokave të punueshme dhe hedhja e këtyre mbeturinave pranë brigjeve të lumenjve. Përveç dëmtimit të peizazhit, mbeturinat e ndërtimit kanë ndikim të dëmshëm në përgjithësi në mjedis e veçanërisht në ekosisteme. Kjo sidomos në rastet kur ato hedhen të përziera me mbeturinat të tjera urbane. Deri me tani nuk ka të dhëna relevante për sasinë e këtyre mbeturinave dhe sipërfaqeve e tokave bujqësore dhe sipërfaqet tjera që zënë ato. Nga vizitat monitoruese në terren të ekipeve të AMMK-se, është vërejtur se këto mbeturina janë evidente në shumë lokacione të Kosovës. Është konstatuar se këto mbeturina zakonisht përdoren për mbushjen e gropave të ndryshme ose për rrafshimin e sipërfaqeve. Në disa raste ato së bashku me mbeturina tjera urbane janë evidentuar si deponi ilegale të mbeturinave. Një shembull i një deponie të tillë është prezantuar në fotografinë vijuese.

¹³ Anketa e mbeturinave industriale 2010, ESK

¹⁴ Anketa e mbeturinave industriale 2010, ASK



Deponi ilegale e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave urbane

3.5 Gjenerimi i mbeturinave të veçanta

Mbeturinat medicinale

Mbeturina medicinale mund të përkufizohet si mbeturinë e gjeneruar si rezultat i diagnostikimit, trajtimit, dhe imunizimit të njerëzve apo kafshëve. Në disa raste mbeturinat spitalore mund të konsiderohet edhe si mbeturina të rrezikshme, që mund të shkaktojnë apo të kontribuojë në paraqitjen e sëmundjeve serioze ose vdekjeprurëse ose atëherë kur ekspozimi ndaj tyre rritë rrezikun për shëndetin e njeriut ose mjedisit, nëse nuk administrohet ose asgjësohet në mënyrën e duhur.

Mbeturinat medicinale përbëhen kryesisht nga ndarjet si me poshtë:

- Kulturat biologjike dhe mbetjet e tyre, dhe stoqe të substancave të infektuara dhe përbërësit biologjik të tyre,
- Mbetje anatomike të indeve trupore, si organe pjesë të trupit duke përfshirë lëngje të indeve të marra gjatë ndërhyrjeve të ndryshme kirurgjikale, autopsive ose procedurave mjekësore.
- Gjak human dhe produktet e tij, materiale të kontaminuara me gjakun human
- Materiale të mprehta si: shiringa, pipeta, lama te mprehta, vegla dhe age, qelq i thyer dhe i pashyer,
- Mbetje të kafshëve duke përmblodhur kërkesat e tyre, pjesët e trupit, lëngje të trupit dhe te tjera pjese biologjike te kafshës,
- Materiale te izolimit te sëmundjeve i kontaminuar me gjak, sekrecione, ekskrecione etj, nga njerëz të izoluar nga njerëz të tjerë për të ndaluar përhapjen e sëmundjeve,
- Pajisjet mjekësore e kontaminuara të ndodhura ne kontakt me material të infektuara,
- Mbetjet laboratorike në kontakt me material biologjik.

Sasia e mbeturinave medicinale që trajtohen në impiantet në 7 qendra spitalore në Kosovë është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 11: Sasia e mbeturinave medicinale në qendrat spitalore për vitin 2013

Viti:2013	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Implianti Prishtine	11423.0	10942.2	12056.0	11640.0	11430.4	10625.0	12363.2	10730.0	11972.7	12080.3	11628.7	11602.8	138494.3
Implianti Prizren	8045.0	7100.0	7631.0	7595.0	7186.0	6899.0	7289.3	7463.3	7795.0	8470.2	7976.6	8274.9	91726.3
Implianti Ferizaj	-	-	-	-	677.0	2024.0	-	1348.0	787.0	-	-	-	4836.0
Implianti Gjilan	307.0	1706.0	1937.0	2714.0	3122.0	2672.5	2477.0	2749.0	2993.0	3150.0	2836.0	2763.0	29426.5
Implianti Mitrovice	4771.0	4690.0	6212.0	4249.0	5331.0	3616.0	3750.0	3504.0	3778.0	3561.0	3600.0	3403.0	50465.0

4. Gjendja e Deponive Sanitare

Menaxhimi efikas i mbeturinave ka rëndësi shumë të madhe për ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Eliminimi i deponimit të mbeturinave dhe menaxhimi i avancuar i deponive sanitare në përgjithësi është me rëndësi fundamentale për secilin vend. Zbatimi sistemeve, programeve dhe projekteve për parandalimin e krijimit të mbeturinave, ndarjen, riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave është forma më e mirë për menaxhimin efikas të mbeturinave.

Kosova si një vend që aspiron procesin e integritimeve evropiane, duhet patjetër të shënojë progres jo vetëm në fushën e menaxhimit të deponive sanitare të mbeturinave, por edhe në të gjitha segmentet tjera të menaxhimit të mbeturinave në pajtim me Direktivat përkatëse BE-së.

Në përgjithësi, deponitë komunale dhe regjionale të mbeturinave urbane të menaxhuara nga ndërmarrjet publike që nga fillimi i funksionimit të tyre janë ballafaquar me probleme operative. Ka pasur probleme të vazhdueshme me operimin e mbeturinave në deponitë sanitare dhe mos respektim të standardeve për deponim të mbeturinave, të cilat shpeshherë nuk janë respektuar nga operatorët gjegjësisht ndërmarrjet publike.

Janë evidentuar edhe raste kur menaxhimi i deponive është përcjellë edhe me probleme tjera operative sikur është mos arkëtimi i mjeteve nga KRM, mos menaxhimi i mirë i aseteve të tyre, investimet e pa arsyeshme si dhe mos mbikëqyrja e KRM-ve nga bordet mbikëqyrëse të këtyre ndërmarrjeve.

Edhe përkundër këtyre problemeve aktualisht në Kosovë mbyllja e deponive sanitare nuk do të ishte si alternativë për zgjedhjen e problemit, sepse kjo do të kishte për pasojë krijimin edhe më të madh të deponive ilegale.

4.1 Deponia Sanitare në Podujevë

Ndërtimi i deponisë komunale të Podujevës ka filluar në vitin 2004 dhe është financuar nga Komisioni Evropian, ndërsa ka filluar të operoj në vitin 2005. Deponia gjendet në lokacionin e quajtur Dumnicë e Epërme. Për shkak të pozitës gjeografike dhe shfrytëzimit vetëm nga komuna e Podujevës kjo deponi aktualisht ka karakter komunal.

Sipërfaqja e përgjithshme e deponisë është 5 ha, ndërsa kapaciteti i përgjithshëm për deponim të mbeturinave është 925.000 m³, me jetëgjatësi të shfrytëzimit për deponim të mbeturinave për 20 vite. Kapaciteti aktual apo sasia ditore e pranimit të mbeturinave në këtë deponi sillet prej 15-20 ton.

Në këtë deponi deponohen mbeturinat e lokaliteteve të komunës së Podujevës. Madhësia e deponisë është 5 ha. Gjendja e deponisë nuk është e mirë, pasi nuk bëhet me rregull shtypja dhe kompatësimi i mbeturinave. Edhe rrjedhja e ujërave nga deponia është e shpeshtë.



Deponia sanitare e mbeturinave në Podujevë

4.2 Deponia Sanitare e mbeturinave në Gjilan

Deponia regionale e Gjilanit gjendet në lokacionin e quajtur Velekinc. Ndërtimi i kësaj deponie është financuar nga Komisioni Evropian dhe punët për ndërtimin e sajë kanë filluar në vitin 2002. Operimi dhe deponimi i mbeturinave në këtë deponi ka filluar në vitin 2003. Në deponi grumbullohen mbeturinat nga Komuna e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Kaçanikut, Shtimes dhe Ferizajt. Sipërfaqja e deponisë është 20.50 ha dhe kohëzgjatja e përdorimit të saj vlerësohet deri në 15 vite. Kapaciteti total është 1.222 222 m³, ndërsa kapaciteti mujor 4000 t¹⁵.

Deponia sanitare e mbeturinave në Gjilan, edhe pse është ndërtuar me standarde, që nga fillimi i funksionit e deri me sot është shoqëruar me probleme operative dhe si pasojë tani është shndërruar në një ndotës potencial për mjedisin. Në këtë deponi here pas here ka djegie të mbeturinave gjë që paraqet rrezik permanent për ndotjen e ajrit dhe mjedisit në përgjithësi. Një kohë nuk ka pasur funksionim të mirë të pompave të ujit, por një përmirësim vërehet në vitin 2012.

Momentalisht pompat janë duke funksionuar dhe nuk ka përzierje të ujërave të deponisë me ujërat sipërfaqësore. Vite më parë nga rrjedhja e ujërave nga deponia dhe përzierja e tyre me ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën përreth deponisë ka ndikuar që ujërat e kësaj zone të jenë të papërdorshme për konsum.



Deponia sanitare e mbeturinave ne Gjilan

4.3 Deponia Sanitare e mbeturinave në Prizren

Deponia sanitare e regjionit të Prizrenit është ndërtuar në vitin 2003 në lokacionin e quajtur Landovicë, ndërsa është lëshuar për operim është lëshuar në vitin 2004. Ndërtimi i kësaj deponie është financuar nga fondet e Komisioni Evropian. Deponia sanitare në Prizren ka sipërfaqe prej 14 ha dhe gjendet në fshatin Landovicë. Në këtë deponi deponohen mbeturinat nga komunat: Gjakovë, Suharekë, Malishevë dhe Rahovec. Deponia ka një kapacitet 2.500.000 m³.

Problemi më i madh në operimin e kësaj deponie është rrjedhja e ujërave në mënyre të vazhdueshme nga deponia si pasojë kësaj vije deri te ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor përreth.

Një problem tjetër është edhe mos mbulimi i mbeturinave të cilat kanë arritur deri te pjesët hyrëse të deponisë.

¹⁵ Raport-Gjendja e Mbeturinave në Kosovë, 2008



Deponia sanitare e mbeturinave në Prizren

4.4 Deponia Sanitare e mbeturinave për regjionin e Prishtinës

Deponia sanitare e regjionit të Prishtinës gjendet në lokacionin e quajtur Mirash të komunës së Obiliq-it. Ndërtimi i kësaj ka filluar në vitin 2004 dhe për operim është lëshuar në vitin 2005. Edhe ndërtimi i kësaj deponie është financuar nga fondet e Komisionit Evropian. Në këtë deponi bëhet grumbullimi i mbeturinave për komunat: Prishtinë, Obiliq, Lipjan. Fushë Kosovë dhe Drenas (Glllogoc). Madhësia e përgjithshme e deponisë është rreth 40 ha. Kohëzgjatja e deponisë është 15 vjet. Kapaciteti total është 3.500 000 m³, ndërsa kapaciteti mujor 6 000 T.

Gjatë vizitave monitoruese të AMMK-së në këtë deponi është konstatuar se gjendja e sajë nuk është e mirë. Problemi më i madh është mos funksionimi i pompave që ka sjellë si rrjedhojë edhe krijimin e një baseni me ujëra të ndotura të cilat përzihen me ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjithashtu, nuk bëhet shtypja dhe mbulimi i rregullt i mbeturinave, andaj kjo ka ndikuar që hapësira për deponimin e mbeturinave të zvogëlohet. Edhe djegia e mbeturinave në deponi është shpesh evidente, sikurse ishte rasti në vitin 2012.



Deponia sanitare e mbeturinave në Mirash

4.5 Deponia Sanitare e mbeturinave në Pejë

Deponia sanitare e regjionit të Pejës, gjendet në lokacionin në Sferk të thatë. Shfrytëzohet nga komuna e Pejës, Deqanit, Istogut dhe Klinës. Ka sipërfaqe mbi 3.5 ha me kapacitet mbi 1.500000 m³. Kjo deponi është ndërtuar në vitin 2001. Ndërtimi i kësaj deponie është financuar nga COPI. Edhe pse kjo deponi fillimisht është menaxhuar mirë, me kalimin e kohës edhe në të janë paraqitur probleme si kurse në rastet e deponive tjera sikurse janë mostrajtimi i ujërave të ndotura dhe rrjedhja e tyre jashtë deponisë, probleme me mbulimin, shtrirjen dhe ngjeshjen e mbeturinave si dhe me zonat e zbrazjes së mbeturinave. Nuk ka trajtim të gazrave dhe si pasojë ka edhe kundërmim të rëndë në deponi dhe po ashtu deponia është pothuajse e stëmbushur me mbeturina.



Deponia sanitare e mbeturinave në Pejë

4.6 Deponia Sanitare e mbeturinave në Dragash

Deponia sanitare e Dragashit është ndërtuar ka fundi i vitit 2003 me donacion nga Bashkimi Evropian. Ka kapacitet mbi 50.000 m³ dhe sipërfaqe prej 1.2 ha. Për shkak të pozitës gjeografike deponia shfrytëzohet vetëm nga komuna e Dragashit. Në këtë deponi që nga fillimi janë paraqitur problemet operative si me shtrirjen, mbulimin dhe ngjeshjen e mbeturinave po ashtu edhe zonat për zbrazjen e mbeturinave dhe problemeve me trajtimin e ujërave të ndotura. Nuk ka gjithashtu as trajtim të gazrave të deponisë dhe nuk funksionon pompa për qarkullimin e ujërave të ndotura zeza, si pasojë e së cilës është mbushur rezervuari për ujëra në deponi që ka rezultuar me rrjedhje të kullimit nga deponia. Aktualisht kjo deponi është shfrytëzuar më shumë se gjysma e sipërfaqes së sajë. Përkundër nevojës për përmirësimin e gjendjen, viteve të fundit nuk ka investime në këtë deponi.



Deponia sanitare e mbeturinave në Dragash

4.7 Deponia Sanitare e mbeturinave në Mitrovicë

Deponia sanitare e regjionit të Mitrovicës, gjendet në lokacionin e quajtur në Gërmovë. Shfrytëzohet për deponimin e mbeturinave nga komuna e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt. Deponia ka një sipërfaqe mbi 7 ha dhe kapacitet i sajë është mbi 2.000.000 m³. Edhe në këtë deponi në vazhdimësi janë paraqitur probleme operative. Operimi jo efikas në deponi ka rezultuar, në mos mbulimin, shtrirjen dhe ngjeshjen e mbeturinave, rrjedhjen e ujërave të ndotura nga e deponisë si dhe kundërmimi. Gjithashtu probleme ka edhe me zonat e zbrazjes së mbeturinave. Nuk ka trajtim të gazrave të deponisë, pompat për qarkullimin e ujërave në deponi nuk funksionojnë dhe si pasojë ka rrjedhje të vazhdueshme të ujërave nga deponia. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes në deponi janë bërë disa investimeve nga DANIDA pas vitit 2001, mirëpo gjendja e saj nuk ka pas përmirësime të dukshme dhe e tillë mbetet edhe sot.

4.8 Deponia Sanitare e mbeturinave në Zveçan

Deponia sanitare e Zveçanit, është ndërtuar në fund të vitit 2003. Edhe kjo deponi është ndërtuar me donacione të BE-së. Deponia përfshin një sipërfaqe prej 3.5 ha, apo 35.000 m² hapësirë të shfrytëzueshme, ndërsa e tërë sipërfaqja e deponisë është mbi 4 hektarë. Deponia e Zveçanit është paraparë të shfrytëzohet nga Leposaviqi, Zveçani dhe Mitrovica. Për momentin, shfrytëzohet vetëm nga Zveçani dhe Mitrovica. Për këto tri vende, kjo deponi, është paraparë të shfrytëzohet për 12 vjet. Deponia në fjalë menaxhohet nga ndërmarrja publike e Zveçanit.



Deponia e Zveçanit

4.9 Stacioni transferues i mbeturinave për regjionin e Ferizajt

Stacioni transferues për mbeturinat komunale gjendet me lokacion e quajtur Gërlic. Stacioni është ndërtuar në vitin 2003, me donacione të BE. Ky stacion transferues, shfrytëzohet nga komuna e Ferizajt, Shtimes dhe herë pas here edhe nga komuna e Shtërpçës. Në këtë stacion bëhet mbledhja dhe grumbullimi ditor i mbeturinave komunale të komunave të cekura më lartë dhe pastaj gjatë ditës ngarkohen në kamion kontejner me kapacitet të madh dhe dërgohen për deponim në deponinë regjionale të Gjilanit.

4.10 Stacioni transferues i mbeturinave në Drenas

Stacioni transferues për mbeturina komunale i komunës së Drenas, gjendet në Çikatovë e vjetër. Ndërtimi i stacionit transferues të mbeturinave komunale të Drenasit është financuar nga MMPH, dhe është ndërtuar gjatë vitit 2010-2011. Ka filluar së funksionuar prej vitit 2012 ku nga qyteti i Drenasit dhe nga zonat tjera të kësaj komune që kanë shërbim për grumbullimin e mbeturinave bëhet mbledhja dhe grumbullimi ditor i mbeturinave komunale në stacion dhe pastaj gjatë ditës ngarkohen në kamion kontejner me kapacitet të madh dhe dërgohen për deponim në deponinë regjionale të Prishtinës.



Stacioni transferues i mbeturinave në Drenas

4.11 Stacioni transferues i mbeturinave në Gjakovë

Stacioni transferues për mbeturina komunale i komunës së Gjakovës, gjendet në periferi të qytetit të Gjakovës, afër lagjes së romëve në lokacionin e quajtur Nakaradë. Ndërtimi i stacionit transferues të mbeturinave komunale të Gjakovës është financuar nga ish Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, gjatë vitit 2008. Ky stacion është destinuar për shfrytëzim vetëm për territorin e komunës së Gjakovës. Në këtë stacion bëhet mbledhja dhe grumbullimi ditor i mbeturinave komunale dhe pastaj gjatë ditës mbeturinat ngarkohen në kamion kontejner me kapacitet të madh dhe dërgohen për deponim në deponinë regjionale të Prizrenit.



Stacioni transferues i mbeturinave në Gjakovë

5. Deponitë ilegale të mbeturinave

Gjatë vitit 2013, AMMK ka bërë identifikimin e të gjitha deponive ilegale në territorin e Kosovës. Identifikimi është bërë në 34 komuna të Kosovës duke përfshiruar Leposaviqin, Zubin Potokun dhe Zveçanin. Gjithsej janë identifikuar 400 deponi ilegale me sipërfaqe të përgjithshme prej 301,18 ha. Lipjani është komuna që ka sipërfaqen më të madhe të deponive ilegale, ndërsa Komuna e Gjilanit dhe ajo e Mamushës kanë sipërfaqen më të vogël sipërfaqen më të vogël me deponi ilegale të mbeturinave.




Fig. 9: Harta e deponive ilegale

6. Deponitë industriale

Format e krijimit të deponive industriale janë të natyrave të ndryshme varësisht nga destinimi i prodhimit apo veprimtarisë. Po thuaj çdo industri në të kaluarën ka trashëguar deponi apo mbetje të rrezikshme të cilat kanë efekte negative në mjedis. Gjithashtu, pos këtyre mbetjeve të deponuara në deponi veçanërisht nga metalet e rënda, substanca në forma të ndryshme agregate kanë mbetur një kohë të gjatë pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale. Me kalimin e kohës, disave nga këto substanca kimike iu ka skaduar afati apo janë degraduar, duke ndryshuar përbërjen e tyre dhe konsiderohen si substanca me rrezikshmëri të lartë. Një sasi e tyre janë të ambalazuara por shumë sosh kanë mbetur të pa mbrojtura dhe të ekspozuara me mjedisin.

Deri me tani për reduktimin e rrezikut nga substanca të këtilla janë bërë aktivitete në disa ndërmarrje, kryesisht duke u mbështetur nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe FSK-së. Si rezultat i prodhimit industrial, ndërprerjes së prodhimit dhe aktiviteteve të tjera, hasen edhe shumë materiale të rrezikshme. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për llojet e këtyre mbeturinave, lokacionet e deponimit/magazinit dhe sasinë e tyre.

Tabela 12: Lloji dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme sipas lokacionit dhe komunave¹⁶

LLOJI I MBETURINAVE	SASIA/NJËSIA	LOKACIONI	KOMUNA
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	49045 m ³	Kosova A	Obiliq
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	186 ton	Kosova A	Obiliq
Burime radioaktive	34 njësi	Kosova A	Obiliq
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	25505 m ³	Shkriortja Trepça	Mitrovicë
Hipoklorur kalciumi	6.5 ton	Shipol	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6300 ton dhe 165 fuqi	Metalurgjia	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	600 litra	Metalurgjia	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	2000 litra	Industria kimike	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substanca kimike të ngurta	10 ton	Tuneli i parë	Mitrovicë
Burime radioaktive	3 fuqi	Tuneli i parë	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	8500 kg	Parku Industrial	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngëta	42900 litra	Parku Industrial	Mitrovicë
Vajrat PCB	4 trafo	Fabrika e plumbit	Zveçan
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	136 ton	Fabrika e plumbit	Zveçan
Tretësira të ndryshme	2 ton	Metalac Janjevë	Lipjan
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	7.0 m ³	Metalac Janjevë	Lipjan
Mbet. e filmave fotografik	3000 kg	IMK-Fabrika	Ferizaj
Koka të rëntgenit	3 copë	IMK-Fabrika	Ferizaj
Mbeturina me substanca kimike të lëngtë	20 ton	Fabrika e Këmbyesve	Ferizaj
Mbet. e filmave fotografik	2.5 ton	Fabrika e veglave	Ferizaj
Ngjyra tekstili, substanca kimike	9100 kg	Sharr-Tex	Sharr
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	4370 kg	Sharr-Tex	Sharr
Vajra të përdorura	1200 litra	“Adi”	Lipjan

¹⁶ Raport i gjendjes së mjedisit 2008

Mbeturinë radioaktive	184 unaza ameri- ciumi	Pallati i Rinisë	Prishtinë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	85 ton	Flotacioni-Trepçë	Leposaviq
Mbeturina kimike të ngurta	22.2 ton	Fabrika e lëkur-këpucëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngtë	17340 litra	Fabrika e auto-pjesëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	200 kg	Fabrika e auto-pjesëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6180 kg	Fabrika e Sharr-Tex	Sharr
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngtë	3265 litra	Fabrika e Sharr-Tex	Sharr
Substanca kimike të ngurta	231.8 kg	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Fuqi plastike me acide	9 fuqi	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Kuti të plastikës të panjohura	9 fuqi	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Substanca shishe pa etiketë	15 copë	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	5 ton	Fabrika e tekstilit	Gjakovë

7. Kimikatet

7.1 Definimi dhe nocionet për kimikate dhe biocide

Kimikatet në përgjithësi janë substanca kimike që përdorën në bujqësi (pesticide, insekticide), për dezinfektim (insekticide, rodenticide), për qëllime industriale dhe shkencore.

Sipas shkallës së rrezikshmërisë kimikatet ndahen në: Kimikate të parrezikshme dhe kimikate të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Kuptimet e nocioneve që përdorën më së shpeshti kur kemi të bëjmë me kimikate janë:

Kimikate - nënkuptohen substancat dhe përzierjet (preparatet) kimike.

Substancat - nënkuptohet elementet kimike ose bashkëdyzimet e tyre në gjendje natyrore, ose të përfituara nga ndonjë proces prodhimi, duke përfshirë çdo lëndë shtesë të nevojshme që shërben për ruajtjen e qëndrueshmërisë së tyre, përkatësisht papastërtitë që rrjedhin nga procesi i prodhimit, duke përfshirë çdo tretës që mund të ndahet pa ndryshuar qëndrueshmërinë e substancës apo përbërjen e saj.

Përzierje - nënkuptohet një përzierje ose tretësirë e përbërë nga dy ose më shumë substancash kimike (fjala "preparat" e përdorur deri me tani ka kuptimin e njëjtë dhe duhet të zëvendësohet me fjalën "përzierje" sipas Rregullores EC 1272/2008).

Produkte biocide- nënkuptohen preparatet kimike që përmbajnë një apo më shumë substanca aktive me qëllim të shkatërrimit, eliminimit apo parandalimit të organizmave të dëmshëm pa shkaktuar efekte të dëmshme në organizmat e tjerë ose në mjedis.

7.2 Prodhimi i kimikateve

Në Republikën e Kosovës nuk ka prodhim të madh të kimikateve pos disa kompanive me kapacitet të ulët të prodhimit sikur janë fabrika për prodhimin e ngjyrave dhe llaqeve. Kimikatet të cilat përdoren në veprimtari të ndryshme në Kosovë zakonisht importohen nga firma të kontraktuara. Për importimin e kimikateve të rrezikshme paraprakisht nevojitet të kërkohet Leje për import nga MMPH, e cila është e nevojshme në pikat kufitare në Doganën e Kosovës.

7.3 Komunikimi i rrezikut nga kimikatet, LST dhe etiketimi - përdorimi

Substancat dhe përzierjet e klasifikuara si të rrezikshme duhet të etiketohen dhe të paktohen në përputhje me klasifikimin e tyre, për të siguruar mbrojtjen e duhur nga rreziqet dhe për të siguruar informacionet e duhura.

Komunikimi i rrezikut nga substancat dhe përzierjet e rrezikshme behet në dy mënyra:

- a) Përmes "Etiketës" dhe
- b) Përmes "Listës teknike të sigurisë nga kimikatet"

"Etiketa" e cila i bashkëngjitet paketimit është i vetmi mjet për komunikim me konsumatorët që shërben për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve dhe ti orientoj ata kah informacioni gjithëpërfshirës për substancat apo përzierjet e dhëna.



Fig. 10: Etiketimi i substancave të rrezikshme

Një substancë ose përzierje e klasifikuar si e rrezikshme, në paketimin e saj duhet të përmbajë etiketën në të cilën duhet përfshirë elementet e mëposhtme:

- emri, adresa dhe numri i telefonit të personit fizik dhe juridik i cili substancat e rrezikshme i vë në treg në Republikën e Kosovës;
- sasia nominale e substancës ose përzierjes në paketim e cila është e dedikuar për përdorim me pakicë, përveç rasteve kur kjo sasi është specifikuar diku tjetër në paketë;
- identifikimi i produktit;
- piktogramet e rrezikut;
- fjalët paralajmëuese/sinjalizuese “Rrezik” ose “Kujdes”;
- deklaratat e rrezikut të tilla si “Zjarr” ose “Rrezik gjithëpërfshirës”, “Fatale nëse gëlltitet” etj.;
- deklaratat përkatëse;
- një seksion për informacion shtesë.

“Lista teknike e sigurisë nga kimikatet” sipas U. A. me Nr. 10/12 duhet ta posedojë çdo person fizik apo juridik i cili prodhon, importon apo i hedhe në treg kimikatet e rrezikshme, gjithashtu blerësin apo përdoruesin e radhës duhet te pajisin falas me këtë Listë.



Fig. 11: Forma e listës teknike të sigurisë për kimikate

LTS për kimikate duhet të përmbajë përmban 16 pika:

- identifikimi i substancave apo përzierjeve/ preparateve dhe personave fizik apo juridik;
- identifikimin e rrezikshmërisë;
- përbërja/ informatat mbi përbërësit;
- masat për dhënien e ndihmës së parë;
- masat për shuarjen e zjarrit;

- masat në rast të derdhjes aksidentale;
- përdorimi dhe magazinimi;
- kontrolli ndaj ekspozimit / mbrojtja personale;
- vetitë fiziko-kimike;
- stabiliteti dhe reaktiviteti;
- informatat toksikologjike;
- informatat ekologjike;
- përdorimi i mbeturinave;
- informatat për transport;
- informatat mbi rregullat;
- informatat tjera.

Rregullat për paketim të substancave dhe përzierjeve të rrezikshme sipas rregullave të vendore dhe të BE-së

- ❖ Substancat dhe përzierjet e rrezikshme (sipas nenit Ligjit të ri për kimikate dhe rregullores së EU 1272/2008) mund të vendosen në treg vetëm nëse janë të paketuara në paketime/ambalazhe të cilat i përmbushin kërkesat e mëposhtme:
 - ✓ paketimi duhet të parandaloj derdhjen ose rrjedhjen e përmbajtjes;
 - ✓ paketimi duhet të jetë i përbërë nga materiale të rezistueshme në qoftë se ato vijnë në kontakt me përmbajtjen;
 - ✓ paketimet duhet të jenë të forta e të qëndrueshme;
 - ✓ paketimi/ambalazhi duhet të ketë mbyllje të shtrëngueshme;
 - ✓ paketimi duhet të përmbajë etiketën me deklaratat dhe shënimet e nevojshme, sipas shtojcave të këtij udhëzimi administrativ.
- ❖ Mbylljet e shtrëngueshme dhe shenjat e prekshme, për disa kimikate, janë të detyrueshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe të verbërve.
- ❖ Njësia paketuuese e destinuar për shitje me pakicë, e cila përmban kimikate të rrezikshme, nuk duhet të ketë:
 - ✓ formën dhe pamjen që mund të jetë tërheqëse për fëmijët ose shkakton kureshtje e tyre, dhe/ose pamjen që e ç`orienton konsumatorin;
 - ✓ formën, pamjen dhe shenjën e cila zakonisht përdoret për ushqime, ushqimet për kafshë, medikamente dhe kozmetikë.

Sipas rregullores (EC) 1272/2008 për CLP (klasifikim, etiketim dhe paketim) të kimikateve të rrezikshme të gjitha simbolet që paraqesin rrezikun nga kimikatet gradualisht duhet të ndërrohen dhe zëvendësohen me piktograme:



Fig.12: Simbolet e rrezikut (forma e vjetër)




Fig. 13: Piktogramet e rrezikut (forma e re)

7.2 Eksporti dhe importi i kimikateve

Kimikatet në Republikën e Kosovës zakonisht përdoren për nevojat e kompanive të mëdha si KEK-ut, Trepçës, por edhe për nevojat e kompanive tjera. Në tabelat vijuese janë paraqitur: lista e kompanive të cilat kanë aplikuar në MMPH për marrjen e lejes për importim të kimikateve dhe biocideve, lista e kimikateve të lejuara për import gjatë vitit 2012 dhe lista e produkteve biocide të notifikuara dhe lejuara për import gjatë vitit 2012.

Tabela 13: Kompanitë të cilat kanë aplikuar në MMPH për leje importi për kimikate të rrezikshme dhe biocide

Emri i Kompanisë	Lloji i lejes së kërkuar
Kompania "Renasanca Impex", Prishtinë	Kimikate të rrezikshme
Sh.p.k."Ripten Engineering", Prishtinë	Kimikate të rrezikshme
Sh.p.k. "Kosovotex"	Kimikate të rrezikshme
N.T.SH. "BIZUN", Prishtinë	Kimikate të rrezikshme
Sh.p.k. "Kosovotex", Prishtinë	Kimikate të rrezikshme
Sh.p.k. "Llamkos- Galva Steel"	Kimikate të rrezikshme
N.t.p. "Eurolab"	Kimikate të rrezikshme
NTSH. "Doktor Exterminator DDD", Prishtinë	Biocide
NTP. "Eramed", Prishtinë	Biocide
NTSH. ,, Fauna", Gjilan	Biocide
Sh.p.k ,, EKO-DDD", Ferizaj	Biocide
Sh.p.k "EcoTech- Pest Control", Suharekë	Biocide

Tabela 14: Lista e kimikateve të lejuara për import gjatë vitit 2012

Kimikati	Qëllimi i përdorimit	Sasia
Cianidi i natriumit NaCN	Import për nevojat e flotacionit "Trepça"	39`600 kg.
Acid klorhidrik HCL dhe	Import për nevojat e "KEK"	500 ton
Hidroksid i natriumit NaOH	Import për nevojat e "KEK"	400 ton
Hidrazin e aktivizuar $N_2H_4 \cdot xH_2O$ (Levoxin 15).	Import për nevojat e "KEK"	17,6 ton
Formaldehid CH_2O 35%	Import për nevojat e KEK -ut	300 kg
Diklor-etan $C_2H_4Cl_2$	Import për nevojat e KEK -ut	10kg
Tetraklorur i karbonit CCl_4	Import për nevojat e KEK -ut	10kg
Amoniak anhidrik	Import për nevojat e kompanisë	35 ton
HCl (acid klorhidrik)	Import për nevojat e "KEK"	deri në 500.000
NaOH (hidroksid i natriumit)	Import për nevojat e "KEK"	deri në 400.000

Tabela 15: Lista e produkteve biocide të notifikuara dhe të lejuara për import gjatë vitit 2012

Substanca aktive	Produkti	Lloji i produktit biocid (PT)	Sasia / forma
Deltamethrin	Aqua K-Othrine	Insekticid	1000 l
Deltamethrin	K-Obiol EC 25	Insekticid	30 L
Deltamethrin	K-Othrine SC 25	Insekticid	30 L
Deltamethrin	Crackdown	Insekticid	30 l -
Imidacloprid	MaxForce IC	Insekticid	300 copë
Imidacloprid	MaxForce - white Cockroach gel	Insekticid	1000 copë-
Imidacloprid	MaxForce Quantum –liquid Ant Bait	Insekticid	50-l
Imidacloprid	Quick Bayt- Fly bait	Insekticid	50 kg
Fipronil	MaxForce FC – Profesional Insect control Roach Killer bait gel	Insekticid	2000 copë
Fipronil	MaxForce FC – Magnum-Roach killer bait gel	Insekticid	1000 copë
Fipronil	MaxForce Gold- gel insecticide	Insekticid	1000 copë
Fipronil	MaxForce Roach bait station	Insekticid	12000 copë
Fipronil	MaxForce FC -ant killer bait gel	Insekticid	6000c cope
Fipronil	MaxForce ffc –ant bait station	Insekticid	4800 copë
Difethialone	Rodilon	Rodenticid	2000 kg
Brodifacoum	Glodacid plus	Rodenticid	2000 kg
Permethrin	Biotol 25 EC	Insekticid	300 l
Bromadiolone	MAKI – Parafin blocs	Rodenticid	1000 kg
Difethialone	Generation- Mini boks	Rodenticid	1000 kg
Difethialone	Blu Max	Rodenticid	1000 kg
Permethrin	Aqua –Kontrol	Insekticid	1000 l
Pyrethrins dhe Pyrethroid	P.I.	Insekticid	120
Pyrethrins dhe Pyrethroid	Pro control	Insekticid	120
Pyrethrins dhe Pyrethroid	ULD BP-100	Insekticid	150 l
Pyrethrins dhe Pyrethroid	ULD BP-300	Insekticid	150 l
Abamectin	PT Avert Cocroach Gel Bait	Insekticid	400 Shiringa
Abamectin	Advance 375A	Insekticid	120 kg
Disodium Tetraborate	Terro- PCO	Insekticid	120 kg
Chlorophacinone	J.T. Eaton A-C Formula 90 –Rodenticide	Rodenticid	1000 kg
Polybutenes	4 The Bird- BIRDS Repellent Liquid	Repelent	375 kg
Polybutenes	Transparent 4 The Bird- Bird Repelent	Repelent	375 kg
Methyl Anthranilate	Fog Force- Bird Repelent	Repelent	375 kg
Sulfur dhe Naftalinë	Snake - a- WAY Snake Repellin Granules	Repelent	120 kg
Block peper oil	Crit Ter Ridder	Repelent	60 kg
Permethrin	Sintores	Insekticid	200 kg
Permethrin	Permefum 14-P	Insekticid	100 cop
Deltamethrin	Metradin Floë	Insekticid	30 kg
Cypermethryn	SEPRA CONTACT	Insekticid	420 kg
Imidaclopride	SEPRA GEL CAFARDS	Insekticid	420 kg
Imidaclopride	SEPRA GEL FOURMIS	Insekticid	420 kg
Bromadiolon	Brodilon Mamac	Rodenticid	204,000 KG
Bromadiolon	Brodilon Pelete	Rodenticid	500,000 KG
Alfa cipermetrin	Neopitroid Alfa	Insekticid	2016,000 PC
Permetryn	Neopitroid prah	Insekticid	40012,000 PC
Benz alkonij klorid	Sinald	Dezifçienc	30,000 PC

Didecildimetil amoni klorid	Vetodez	Dezifçienc	30,000 PC
Troklozen natri dihidrat	Chlormax	Dezifçienc	2010,000 PC
Troklozen natri dihidrat	Chlormax	Dezifçienc	200,000 PC
Klorheksidin diglukonat	D-V konc dezinf	Dezifçienc	200,000 PC
Bifenase	Bifenthrin	Insekticid	3600 ml
Rodexion	Bromadialone	Rodenticid	25 kg
Facorat Pelletes	Denatonium benzoate	Rodenticid	25 kg
Permethrin	SINTOREX	5.0 Kgx10	
Cypermethrin (cis.trans40/60)	Deadyna	Insekticid	66 l
Piretrine naturali	Piretrox 714	Insekticid	30 l
Cypermethrin (cis trans)	Permex 22	Insekticid	66 l
Cypermethrin	Cipex 10	Insekticid	60 pc
Brodifacoum	Brodibleu wax Blocs	Rodenticid	200 kg
Bromadielone	Bromobleu pasta bait	Rodenticid	100 kg
Bromadielone	Bromobleu waks blocs	Rodenticid	150 kg
Bromadielone	Bromobleu fresh pasta	Rodenticid	100 kg
Sulfur+naftalinë	Snake away	Repellent	/
Cypermethrin	FOVAL CE	Insekticid	740 l
Tetramethrin	ANTIVESPE	Insekticid	384 l
Permethryn	GIAGUAR Mosche e Zenzare	Insekticid	384 l
Imidacloprid	FOVAL GRANULI Mosche milk	Insekticid	100 kg
Cypermethrin	EXIT DUST	Insekticid	100 kg
Permethryn	GEOTOX	Insekticid	240 l
Imidacloprid	Foval Gel Scarafaggi	Insekticid	129. 4 kg
Imidacloprid	Foval Gel Formiche	Insekticid	48 kg
Imidacloprid	Trap Kill Antiformiche	Insekticid	120 kg
Brodifacoum	Brody Blochi Parafinati	Rodenticid	600 kg
Brodifacoum	Brody Croccantini	Rodenticid	400 kg
Brodifacoum	Brody Esca Fresca	Rodenticid	400 kg
Difenacoum	Diferat Esca Fresca	Rodenticid	200 kg
Bromadiolone	Ratibrom 2 Esca Fresca	Rodenticid	400 kg
Metaldehyde	Agrosan –B (metaqinque) snail bait	Molluscocid	4000 kg
Chlorophacinone	Arvyrat	Rodenticid	1920 kg
	Norat	Ngjitës	121.5 kg
	Kolrat	Ngjitës	80 kg
imidacloprid	Victor Gel gegen Schaben	Insekticid	700 cope
Brodifacoum	Brodifacoum wax blocks	Rodenticid	1500 kg
Brodifacoum	Detia Rat Bait (Paste)	Rodenticid	700 cope
Brodifacoum	Detia Mole –Free	Rodenticid	700 cope
Aluminium phosphide 56 %	Vole Killer	Rodenticid	1500 cope
Permethrin 05%	Ameisenmittel	Insekticid	700 cope
Calcium Oxide/carbide	Delu Ëuhimagas	Repellent	2000 cope
Bendiocarb	Serpa Gel Plus	Insekticid	1008 kg
Vajra bimësh dhe acide të kombinuara	Flock Buster	Repellent	200 L

8. Mbetjet nga kimikatet

8.1 Depot me mbeturinat nga kimikatet

Në Kosovë pas viti 1999, mbeturinat nga kimikatet janë deponuar në shumë vende të ndryshme të Kosovës si depo, garazha apo podrume pa ndonjë standard për ruajtjen e tyre. Mbetjet e kimikateve më përbërje të ndryshme janë si produkt i prodhimit industrial. Depot me mbetjet e kimikateve monitorohen gjatë tërë vitit nga KFOR, FSK, dhe Inspektorati Mjedisore i MMPH-së.

Tabela 15: Vend deponimet me mbeturinat e kimikateve industriale

Nr.	Komuna	Emri i lokacionit	Aktiviteti
1	Lipjan	GC Metal	Prodhim të metaleve
2	Obiliq	TC Kosova A	Prodhim i energjisë elektrike
3	Obiliq	TC Kosova B	Prodhim i energjisë elektrike
4	Graçanicë	Kishnicë/Trepça	Koncentrik të flotacioneve
5	Fushë Kosovë	Sole Koral	Makineri ftohëse
6	Glllogoc	Newco Ferronikeli Complex L.L.C	Shkritoja
7	Mitrovica	Stariterg	Koncentrat i flotacionit
8	Mitrovica	Tuneli i parë	Burim radioaktiv
9	Leposaviq	Trepça	Koncentrat i flotacionit
10	Mitrovica	PIM	Parku Industrial
11	Zveçan	Trepça	Koncentrat
12	Pejë	Kombinati i lëkurëve	Prodhim i lëkurës (nuk ka aktivitet)
13	Pejë	Trepça	Prodhim i baterive (zvogëlim i aktivitetit)
14	Pejë	Eurostell	Prodhim i pjesëve dhe pajisjeve për makineri të ndryshme
15	Gjakova	Jatex	Prodhim i tekstit
16	Gjakova	Metaliku	Prodhim i sektorit të hekurit (nuk ka aktivitet)
17	Gjakova	Devolli group	Prodhim i tekstit (nuk ka aktivitet)

Përbërja, lloji dhe sasia e mbetjeve të kimikateve nuk është e njohur. Informatat më detale i posedon KFOR-i, i cili edhe bënë monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Në përgjithësi mbetjet e kimikateve të depozituar në vende të ndryshme, mund të kenë veti: eksplozive, oksiduese, të ndezshme, helmuese, korrozive, irrituese, kancerogjene, mutagjene dhe forma tjera të rrezikshme për mjedisin.

Me një depozitim të tyre pa një standard të duhur të mbrojtjes dhe izolimit ndaj mjedisit, ato janë shkaktar të ndotjes së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, ajrit dhe tokës.

8.2 Barnat me afat të skaduar

Në vitin 2011, nga Depoja në Mazgit është marrë e tërë sasia e barnave me afat të skaduar dhe është asgjësuar përmes formës së djegies pa përfitim të energjisë. Sasia e përgjithshme e këtyre barnave ishte 337.632 kg.

Në vitin 2011, nga të gjitha QKMF të Republikës së Kosovës, Spitalet Rajonale, IKSHPK dhe IRSHP në Mitrovicë që kanë pasur material medicinal për asgjësim dhe barna me afat të skaduar është mbledhur materiali. Sasia e përgjithshme e këtij materiali ishte 150462 kg.

Sasia totale e barnave dhe materialit medicinal të cilat gjenden në depot e Prishtinës është 2358077 copë ku 2226721 copë janë barna me afat të skaduar dhe 131356 copë material medicinal me afat të skaduar.

8.3 Hotspotet mjedisore nga mbeturinat dhe kimikatet

Hot-spotet mjedisore janë krijuar dhe të trashëguara si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave, nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide të skaduar etj. Hotspotet kanë shpërndarje të ndryshme në territorin e Kosovës duke bart me vete kërcënimin e vazhdueshëm në mjedis dhe shëndetin e popullatës. Strirja hapësinore e këtyre hotspotëve është prezantuar në figurën vijuese.




Figura 14. Harta e shpërndarjes së lokacioneve të hotspotëve në Kosovë

Ndërsa në tabelën vijuese janë prezantuar disa të dhëna për hotspotet mjedisore nga mbeturinat dhe kimikatet, përfshirë lokacionin, sipërfaqen dhe burimet potenciale të ndotjes nga to.

Tabela 16. Hot-spotet mjedisore sipas lokacioneve, aktivitetit, sipërfaqes dhe burimeve potenciale të ndotjes¹⁷

Nr.	Lokacioni	Aktiviteti në të kaluarën	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Kemikalie	Vajra	Materie organike	Tjetër
1.	Objekti i ish Ndërmarrjes së Agro-Kulturave në Shirokë-Komuna e Therandës	Depo për mbeturina të pesticideve dhe fertilizues	0.04 ha	-	+	-	-	-
2.	Objekti i ish Fabrikës së automjeteve në Pejë	Depo për kemikale të rrezikshme industriale	0.12 ha	-	+	+	-	-
3.	Deponia Sanitare komunale në Podujeve	Deponi e mbeturinave	8.72 ha	-	+	+	+	+
4.	Deponia Sanitare komunale në Pejë	Deponia e mbeturinave	4.85 ha	-	+	+	+	+
5.	Deponia sanitare regjionale në Gjilan	Deponi e mbeturinave	20.50 ha	-	+	+	+	+
6.	Deponia sanitare regjionale në Prizren	Deponi e mbeturinave	20.94 ha	-	+	+	+	+
7.	Deponia sanitare regjionale në Mirash-Obiliq	Deponi e mbeturinave	33.65 ha	-	+	+	+	+
8.	Deponia sanitare komunale në Mitrovicë	Deponi e mbeturinave	3.60 ha	-	+	+	+	+
9.	Fabrika për prodhim të gomave dhe trakave-Suharekë	Mbetje të vajrave dhe kontaminim i tokës	17.17 ha	-	+	+	-	-
11.	Parku Industrial Mitrovicë	Deponit industriale	115.10 ha	+	+	-	-	-
12.	Deponia Industriale e Feronikelit-Çikatovë-Drenas	Deponia e Skories industriale te Feronikelit	24 ha sip, zona e ndikimit 71.37 ha	+	-	-	-	-
13.	Deponia e Minerës afër pendës, Badovc	Deponia me metale të rënda	2.85 ha	+	-	-	-	-
14.	Deponia e materialit steril në Kishnicë	Deponia me metale të rënda	10.23 ha	+	-	-	-	-
15.	Deponia e Mareci 1 dhe Deponia Mareci 2, Prroji i djaloshit, Miniera Artanë	Deponia me metale te rënda	2.38 ha	+	-	-	-	-
16.	Deponia në Kelmend-Mitrovicë	Deponia me metale te rënda	23.78 ha	+	-	-	-	-
17.	Materiet radioaktive në kombinatin industriale në Trepçe Mitrovicë	Objekti-Deponim me metale radioaktive, Nitrati Toriumi	0.04 ha	-	-	-	-	+
18.	Materiet radioaktive te Tuneli i Parë, Mitrovicë	Objekti-Deponim me metale radioaktive, Stronciumi, Torium dhe Americium	0.03 ha	-	-	-	-	+
19.	Deponitë industriale në Zveçan	Deponi të metaleve të rënda	62.28 ha	+	-	-	-	-
20.	Deponit industriale në Leposaviq	Deponi te metaleve te rënda	20.31 ha	+	-	-	-	-
21.	Deponia e hirit në TEC A	Deponitë industriale termoenergjetike	181.97 ha	+	+	+	-	+
22.	Deponia e Hirit në TEC B	Deponit industriale termoenergjetike dhe areali i ndikimit	192.94 ha	+	+	+	-	+
23.	Rezervuaret me fenole	Rezervuare me fenole	177.64 ha	+	x	x	-	x
24.	Deponia e Minerës në Devë-Gjakovë	Deponi me metale të rënda	5.23 ha	+	-	-	-	-
25.	Miniera në Golesh-Komuna e Lipjanit	Eksplotimi dhe përpunimi i metaleve të rënda	15.13 ha	+	-	+	-	-
26.	Hani i Elezit, Kompleksi industrial SharrCem	Dy deponi të me materie të asbestit	0.60 ha	+	+	-	-	+

17 Raporti Hotspotet mjedisore në Kosovë, AMMK 2011

9. Trajtimi i mbeturinave dhe kimikateve

Në Kosovë ekzistojnë disa kompani që merren me grumbullimin e llojeve të veçanta të mbeturinave si letër, plastikë, metale, bateri, kanaçe, goma, vajra etj.

Në mungesë të impianteve për riciklim dhe përpunim të mbeturinave, një pjesë e konsiderueshme e këtyre kompanive, merret vetëm me grumbullimin dhe presimin (shtypjen) e tyre për ti eksportuar pastaj në vende të tjera të rajonit, të cilat kanë impiante për riciklimin e këtyre mbeturinave.

Kompanitë grumbulluese të mbeturinave të llojeve të ndryshme në Kosovë, edhe pse janë të shumta në numër, kanë kapacitet të vogël dhe shumë prej tyre janë të pa licencuara për veprimtarinë e tyre.

9.1 Riciklimi i mbeturinave

Riciklimi i mbeturinave është proces përmes së cilit nga mbeturinat nxirren përfitime teknike, ekologjike dhe ekonomike. Rëndësia e riciklimit qëndron edhe në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave komunale dhe industriale që dërgohen në deponi sanitare, dhe në mënyrë indirekte kjo ndikon edhe në rritjen e jetëgjatësisë shfrytëzimit të deponive sanitare. Përmes trajtimit të mbeturinave me metodën e riciklimit krijohen mundësia e ri shfrytëzimit të lëndëve sekondare duke u krijuar produkte të reja por edhe duke zvogëluar shfrytëzimin e burimeve të reja natyrore për të njëjtin qëllim.

Në Kosovë, ka pak impiante për riciklimin e mbeturinave. Kryesisht riciklohen mbeturinat e plastikës dhe të letrës. Disa kompani ricikluese të mbeturinave të plastikës bëjnë riciklimin dhe përfitimin e produkteve të reja. Ka raste kur bëhet riciklimin e folies së najlonit ose edhe riciklimi i PVC-së.

Ekzistojnë edhe disa kompani të vogla që përmes riciklimit të letrës përfitojnë ambalazhe për vendosjen e vezëve, paketa dhe letër toaleti. Një shembull tjetër që mundë të përmendet në kontestin pozitiv është edhe projekti për mbledhjen dhe riciklimin kapakëve të shisheve të ujit për sigurimin e karrocave për persona me të aftësi të kufizuar.

Në tabelën vijuese është paraqitur lista e operatorëve të licencuar që merren me mbledhjen, transportimin dhe riciklimin e mbeturinave.

Tabela 17: Lista e operatorëve të licencuar që merren me mbledhjen, transportimin dhe riciklimin e mbeturinave

Nr.	Emri i operatorit/ kompanisë	Vendi	Veprimtaria
1	N.t.p. Higjiena	Hani i Elezit	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
2	N.p.sh. Mbrojtja e ambientit	Ferizaj	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
3	Sh.p.k.Mobile Sanitary Services	Prishtinë	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
4	N.t.sh. Krasniqi	Kaçanik	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
5	Sh.p.k. Toifor	Prishtinë	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
6	N.t.sh. Prestigj Media	Lipjan	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
7	Sh.p.k.. Kras	Hani i Elezit	Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore
8	N. sh. Shërbimi	Prizren	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
9	DCH Limitet	Prishtinë	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
10	Sh.p.k. "igani	Prishtinë	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
11	N.sh. Pastërtia	Hani i Elezit	Mbledhje, grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale
12	Sh.p.k. EcoHigjiena	Gjilan	Mbledhje, grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale
13	N.p.sh. Stagova	Ferizaj	Mbledhje, grumbullim përpunim, riciklim deponim/magazinim, përpunim fizik të mbeturinave të gomës

14	K.r.m. Eko Regjioni Sh.A.	Prizren	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
15	N.p. Victoria Invest International sh.p.k	Suharekë	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
16	N.t.p. Autogoma	Ferizaj	Mbledhje, grumbullim, ripërpunim, trajtim dhe riciklim i gomave të përdorura
17	Sh.p.k. Eko Drinia	Rahovec	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
18	Sh.p.k. Is-Company	Prizren	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
19	K.r.m. Pastrimi SH.A.	Prishtinë	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
20	N.t.sh. "Pastrimi"	Deqan	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
21	K.r.m. "Pastërtia" SH.A.	Ferizaj	Mbledhje, grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale
22	K.r.m. "Çabрати" SH.A.	Gjakovë	Mbledhje, grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale
23	N.sh.t. Zahiri	Prishtinë	Mbledhje dhe transportim të mbeturinave komunale
24	Sh.p.k. Euro Still	Pejë	Mbledhje, grumbullim dhe transportim, përpunim, ndarje, transportim, deponim/magaznim, përpunim fizik të mbeturinave
25	Sh.p.k. Rec-Cos	Fushë Kosovë	Mbledhje, grumbullim përpunim riciklim deponim/magaznim, përpunim fizik të mbeturinave metalike, plastike etj.
26	Sh.p.k. Italy Recycling	Obiliq	Mbledhje, grumbullim dhe transportim, përpunim, ndarje, transportim, deponim/magaznim, përpunim fizik të mbeturinave
27	Sh.p.k. G- Plus	Obiliq	Mbledhje, grumbullim përpunim, riciklim deponim/magaznim, përpunim fizik të mbeturinave metalike

9.2 Ripërdorimi i mbeturinave në Kosovë

Disa prodhime janë të dizajnuara në atë mënyrë që mund të shfrytëzohen disa herë. Rregullorja e BE për ambalazhim, u sugjeron prodhuesve ta shqyrtojnë mundësinë për ripërdorimin e ambalazhit.

Në rastet tjera prodhimet mund të përpunohen për qëllime të njëjta apo të ngjashme. Përdorimi i sërishëm i qeseve të najlonit ose kavanozave të qelqit, janë shembuj të shpeshtë.

Ekzistojnë disa arsye për ripërdorimin e prodhimeve:

- kursehet në energji dhe lëndë të parë,
- zvogëlohen shpenzimet për deponim,
- zvogëlohen shpenzimet për tregtarë dhe konsumatorë.

Me rëndësi shumë të madhe, është edhe numri i gjërave që ripërdoren, gjegjësisht koha e prodhimit.

Në Kosovë ka raste të ripërdorimit të shisheve PET për rezervim të ujit por edhe për mbushje me qumësht dhe shitjen e tij në treg.

Fabrika e birrës në Pejë i ripërdor shishet e birrës 0.5 litërshe për rimbushje, duke i dhënë ato me kompensim (kaucion).

Konsumatorët disa nga qeset e forta të plastikes i ripërdorin për hedhjen e mbeturinave dhe shumë pak për blerje në treg.

Gjithnjë e më shumë ka iniciative për hapjen e dyqaneve me produkte të përdorura ku përfshihen veshmbathje, pajisje elektrike dhe elektronike, goma të përdorura e gjësende të tjera. Në të shumtën e rasteve këto produkte po importohen nga shtetet e perëndimit, dhe kjo përveç aspektit pozitiv që ka në procesin e riciklimit ka edhe atë negativ pasi që shumë prej tyre kalojnë në mbeturina gjë që ndikon në shtimin e sasisë së mbeturinave.

9.3 Trajtimi i mbeturinave medicinale

Mbetjet spitalore prodhohen nga shume subjekte mjekësore, të cilat prodhojnë një sasi të konsiderueshme mbetjesh të rrezikshme. Trajtimi i këtyre mbetjeve në respektimin e mjedisit është detyrë profesionale dhe etike e të gjithë operatorëve mjekësorë. Ky trajtim duhet të eliminojë potencialin patogjen që ketë mbetje përmbajnë, në mënyrë që të reduktohet ndotja e ambientit, toksiciteti kimik dhe radioaktiv.

Mbetjet mjekësore mundë të shkaktojnë infeksione nëse vijnë në kontakt me lekuren, sytë, ajrin, gojën ose nëse ato në forma të ndryshme depërtojnë në trupin e njeriut. Këto mbetje duhet të trajtohen vetëm në vendet e lejuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe operatorët duhet të janë të pajisura me leje përkatëse.

Trajtimi i mbeturinave spitalore rregullohet përmes: Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2008 për asgjësimin e mbeturinave të produkteve medicinale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale.

MMPH ka ndërtuar impiante për sterilizim të këtyre mbetjeve spitalore. Ko ka ndikuar që të në një masë të zgjidhet problemi i mbetjeve medicinale në Spitalet Regjionale të Kosovës por njëkohësisht edhe në zvogëlimin e volumit të mbeturinave që deponohen në deponitë sanitare.

Aktualisht janë në funksion impiantet për trajtimin e mbeturinave medicinale në: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj, ndërkohë që së shpejti pritet të fillojë së funksionuari edhe impianti në Pejë.

Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Prishtinë

Ky impiant është i vendosur në hapësirat e QKUK-se. Kapaciteti i këtij impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli dhe brenda ditës mundë të zhvillohen 5 deri në 6 cikle.

Nga institucionet shëndetësore publike në këtë impiant trajtohen mbeturinat spitalore nga shtëpitë e shëndetit të qytetit të Prishtinës dhe nga QKUK-ja, si dhe një sasi e vogël vjen edhe nga institucionet private shëndetësore nga KFOR dhe EULEX.

Gjendja në këtë impiant është e mirë. Impianti punon me kapacitet të plotë. Sasia mesatare mujore e mbeturinave medicinale që trajtohet në këtë impiant është rreth 11.000 kg.



Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Prishtinë

Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Mitrovicë

Ky impianti është i vendosur në hapësirat e Spitalit Regjional të Mitrovicës. Kapaciteti i tij për trajtimin e mbeturinave medicinale është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli dhe brenda ditës mundë të zhvillohet 5 deri në 6 cikle.

Nga institucionet shëndetësore publike në këtë impianti dërgohen për trajtim mbeturinat spitalore nga shtëpitë e shëndetit të qytetit të Mitrovicës dhe nga Spitali Regjional i Mitrovicës.

Gjendja në impianti është e mirë. Impianti punon me kapacitet jo të plotë. Sasia mesatare mujore e mbeturinave medicinale që trajtohet në këtë impianti është afërsisht 4.700 kg.



Pajisjet për trajtimin e mbeturinave medicinale

Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Gjilan

Impianti është i vendosur në hapësirat e Spitalit Regjional të Gjilanit. Kapaciteti i implantit për trajtimin e mbeturinave medicinale është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli, e brenda ditës mundë të kryhen 5 deri në 6 cikle trajtimi. Në impianti trajtohen vetëm mbeturinat nga Spitali Regjional i Gjilanit.

Edhe pse gjendja e implantit është e mirë, ai punon me kapacitet jo të plotë, sepse në impianti punon vetëm një punëtorë i cili në të njëjtën kohë është përgjegjës edhe për lavanderinë. Sasia mesatare mujore e mbeturinave medicinale që trajtohet në impianti është rreth 400 kg.



Mbeturinat spitalore pas trajtimit

Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Pejë

Është i vendosur në hapësirat e Spitalit Regjional të Pejës. Impianti ende nuk ka filluar punës sepse ende nuk është bërë pranimi teknik i tij.

Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Gjakovë

Ky implant është i vendosur në hapësirat e Spitalit Regjional në Gjakovë. Kapaciteti i tij për trajtimin e mbeturinave medicinale është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli, ndërkohë që brenda ditës mund të kryhen 5 deri në 6 cikle. Aktualisht implanti futet në funksion vetëm herë pas here. Që nga fillimi i punës së tij, brenda 8 muajve janë zhvilluar vetëm 40 cikle. Sasia ditore e mbeturinave që dërgohen në implant është shumë e vogël, vetëm rreth 10 kg në ditë.



Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Gjakovë

Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Prizren

Impianti është i vendosur në hapësirat e Spitalit Regjional në Prizren. Kapaciteti i tij impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli dhe gjatë një dite mund të kryhen 5 deri në 6 cikle. Në impiant aktualisht trajtohen mbeturinat medicinale që vijnë nga Spitali Regjional i Prizrenit dhe nga qendrat e vaksinimit. Impianti punon me kapacitet të plotë dhe gjendja e tij është e mirë. Sasia mesatare mujore e mbeturinave medicinale që trajtohet është afërsisht 4.500 kg.

Impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale në Ferizaj

Është i vendosur në afërsi të Shtëpisë së Shëndetit në Ferizaj. Kapaciteti i tij është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli. Impianti ka filluar punën në korrik të vitit 2012. Impianti nuk punon me kapacitet të plotë. Brenda ditës kryhet vetëm një cikël i trajtimit të mbeturinave medicinale. Në impiant aktualisht dërgohen për trajtim mbeturinat medicinale nga Spitali Regjional i Ferizajt dhe Shtëpitë e Shëndetit të Ferizajt. Sasia mujore e mbeturinave që trajtohen në impiant është rreth 1000 kg.

9.4 Djegia e mbeturinave

Një formë tjetër e trajtimit të mbeturinave është edhe djegia. Trajtimi i mbeturinave përmes djegies pa përfitim të energjisë është i shpeshtë në Kosovë. Kjo bëhet zakonisht me qëllim të zvogëlimit të sasisë së mbeturinave infektuese ose të asgjësimit të tyre.

Raste të shpeshta janë djegia e barnave të konfiskuara nga dogana ose ato me afat të skaduar, ose edhe djegia e artikujve të ndryshëm të konfiskuar nga dogana si mallra me përbërje të dyshimta ose të falsifikuara. Djegia bëhet në impiante të cilat kanë autorizim mjedisor nga MMPH, ose në qendrat spitalore që kanë impiante për djegien e mbeturinave.

Ka edhe raste të djegies së mbetjeve të vajrave të përdorur për përfitim të energjisë kryesisht për ngrohje edhe pse një veprim i tillë nuk është i lejuar si dhe raste të djegieve të mbeturinave në deponi të ndryshme ilegale.



Djegia e mbeturinave komunale

9.5 Trajtimi i mbeturinave të rrezikshme

Mbeturinat e rrezikshme janë substancat të cilat për një kohë të gjatë kanë mbetur pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale. Me kalimin e kohës këtyre substancave kimike iu ka skaduar afati apo janë degraduar duke ndryshuar përbërjen e tyre dhe konsiderohen si substanca me rrezikshmëri të lartë.

Në këtë grup hyjnë:

Mbeturinat e rrezikshme të cilat janë mbeturina që kanë së paku njërën nga këto karakteristika: eksplozive, oksiduese, të ndezshme, toksike, kanceroze, korrozive, irrituese, dëmtuese, infektuese, teratogjenike, mutagjenike, që lirojnë gazra toksike në kontakt me ujë, ajër ose substanca acidike. Mbetje të rrezikshme janë edhe ato që mund të përdoren për prodhimin e substancave tjera të rrezikshme ose ekotoksike.

Mbeturinat industriale të cilat prodhohen nga aktivitetet ose proceset industriale ose të prodhimtarisë artizanale dhe aktivitetet tjera prodhuese.

Mbeturinat speciale janë mbeturina radioaktive, kontejnerët e përdorur të gazrave të presuara, mbeturinat që përmbajnë përqendrime të mëdha të metaleve të rënda toksike (arsen, plumb etj), ose që përmbajnë substanca kimike me afat të skaduar.

Mbeturinat kimike dhe farmaceutike janë mbeturinat nga produktet farmaceutike dhe kimike brenda ambalazheve të tyre.

Për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme përdoren procese të ndryshme fizike, kimike, biologjike dhe termale që kanë për qëllim largimin ose pakësimin e vetive të rrezikshme dhe të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut që kanë këto mbeturina.

Në Kosovë si shembull i trajtimit të mbeturinave të rrezikshme mund të përmendet trajtimi i fenoleve. Procesi i trajtimit të tyre është bërë përmes tenderimit, të cilin e ka fituar kompania Greke "Environmental Protection Engineering-S.A". Kjo kompani mbeturinat e rrezikshme të fenolëve i ka eksportuar në disa shtete të Evropës si në Suedi, Gjermani, Belgjikë, Poloni dhe Bullgari ku dhe është bërë trajtimi dhe asgjësimi i tyre.

Në tabelën në vijim janë prezantuar llojet dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme të eksportuara për trajtim.

Tabela 19: Llojet dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme të eksportuara për trajtim

Lloji i substancave të transportuara jashtë Kosovës	Sasia (ton)
LHOC (likuide me përmbajtje të lartë organike)	1195.6
Solvent	19.5
Diisopropylether	35.47
Tar sluge (Llum katrani)	3297.32
Tar condensate (Kondenzat katrani)	192.82
Drums (Katran nga fuqitë)	35
Tar deposit (Katran nga katrani i depozituar mbi sipërfaqe të tokës)	18.8

10. Investimet në sektorin e mbeturinave

Një ndër investimet më të rëndësishme nga MMPH në sektorin e mbeturinave mundë të konsiderohet implementimi i projekteve të përfshira në kuadër të Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis. Në kuadër të këtyre projekteve janë ndërtuar impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore në shtatë Qendra Spitalore Regionale: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj dhe Mitrovicë dhe Pejë.

Projekte tjera me rëndësi në sektorin e mbeturinave që janë realizuar nga MMPH gjatë dy viteve të fundit janë edhe:

- Ndërtimi i stacionit transferues për mbeturinat komunale për komunën e Drenasit,
- Pastrimi i lumit Lepenc nga mbeturinat e azbestit.
- Furnizim me kontejner për mbeturina komunale, mbështetje për infrastrukturën për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave komunale.

Disa nga projekte më të rëndësishme në sektorin e mbeturinave të përkrahura nga donatorët janë:

- Projekti për furnizim me kamion vetëngarkues dhe pajisje për sistemin për mbledhjen e mbeturinave komunale për regjionin e Prizrenit dhe komunën e Prishtinës nga JICA - Japoneze.
- Projekti për hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave komunale për komunën e Prishtinës nga GIZ – Gjermane.
- Projekti për hartimin e planit për menaxhimin e mbeturinave komunale për komunën e Hanit të Elezit nga LOGOS.
- Projekti për studimin e fisibilitetit për gjendjen e mbeturinave në komunën e Pejës nga USAID,
- Hartimi i Ligjit për produkte Biocide dhe Strategjia për administrimin e mbeturinave 2011 -2020, është mbështetur nga TAIEX,
- Projekti i Binjakëzimit- Mbështetje institucionale për MMPH-në me përkrahjen e Komisionit Evropian.

Nga buxheti i përgjithshëm për infrastrukturën mjedisore për vitin 2012, që është 815,000.00 €, 700.000 € kanë qenë të destinuar në sektorin e mbeturinave.

Në tabelën vijuese janë paraqitur disa nga projektet e lartpërmendura në sektorin e mbeturinave dhe shuma e investimeve e cila për vitit 2009-2011 është 5.208.700.00 €.

Tabela 20: Disa nga projektet e realizuara në sektorin e mbeturinave 2009-2012 në Euro

Nr.	Titulli i projektit	2009	2010	2011	2012
1	Ndërtimi i objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme	341,000.00	341,000.00	300,000.00	
2	Ndërtimi i impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive	750,000.00	750,000.00	250,000.00	250,000.00
3	Rehabilitimi i deponive të vjetra të mbeturinave nëpër komunat e Kosovës	300,000.00	300,000.00		
4	Hartimi i projektit socio ekonomik për lumin Bistrica – Prizren	300,000.00	300,000.00		
5	Pastrimi i lumit Lepenc nga ndotja e azbestit		176,700.00		250,000.00
6	Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave				200,000.00

11. Ndikimet sociale dhe përfitime nga politikat e menaxhimit efikas dhe parandalimit të mbeturinave

Mbeturinat janë produkt i aktiviteteve ekonomike, bizneseve, amvisërisë, prodhimit të energjisë apo edhe sektorëve tjerë zhvillimorë. Mbeturinat po ashtu konsiderohen edhe si resurs ekonomik.

Zvogëlimi i mbeturinave që nga procesi i prodhimit e deri te konsumatori i fundit ka një rëndësi të veçantë për përfitime ekonomike dhe mjedisore. Përfitimet mjedisore në radhë të parë konsiderohen zvogëlimin e ndotjes që vjen nga mbeturinave në mjedis por edhe në zvogëlimin e sipërfaqeve të nevojshme për deponimin e mbeturinave.

Reduktimi i mbeturinave nëpër proceset e prodhimit ka ndikim pozitiv edhe në aspektin e zvogëlimit të emisioneve të gazrave serrë si dhe në kursimin e burimeve për prodhimin e energjisë. Parandalimi i mbeturinave ka rëndësi edhe në zvogëlimin e shpenzimeve për trajtimin e tyre dhe zvogëlimin e koston për transportimin e tyre deri në deponi, por edhe në zvogëlimin e koston për mirëmbajtjen e deponive dhe në jetëgjatësisë e shfrytëzimit të tyre.

Përfitimet ekonomike që rrjedhin nga politikat e parandalimit të mbeturinave përmes riciklimit, ripërdorimit dhe trajtimit janë të shumfishta. Këto përfitime ekonomike janë të ndërlidhura edhe me përfitime sociale qoftë përmes mundësisë për krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e të hyrave financiare por edhe krijimin e kushteve me të mira të jetesës.

12. Ndikimet në mjedis nga mbeturinat dhe kimikatet

Ndotja e mjedisit nga mbeturinat dhe kimikatet është një ndër problemet më të shpeshta mjedisore në shumë vende të botës. Edhe Kosova, ka probleme të dukshme mjedisore që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave dhe kemikateve. Ndikimi i mbeturinave në mjedis është i mënyrave dhe formave të ndryshme.

Mungesa e sistemit për ndarjen dhe klasifikimin mbeturinave është një nga problemet fillestare në vargun e problemeve tjera në sektorin e mbeturinave. Kjo më pastaj përcillet me problemin e dërgimit në deponi sanitare jo vetëm të mbeturinave komunale por edhe të llojeve të tjera të mbeturinave.

Shkalla e ulët e trajtimit, riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave është një segment tjetër që i kontribuon gjendjes së rëndë në sektorin e mbeturinave dhe ndikimit të tij në mjedis.

Deponitë sanitare edhe pse të ndërtuara sipas standardeve, për shkak të keqmenaxhimit janë shndërruar në ndotës potencial të mjedisit dhe ndikimit në shëndetin publik. Hulumtimet e ndryshme tregojnë se njerëzit dhe bota tjetër e gjallë, që jetojnë në arealin prej 2 km larg deponisë, janë të ndikuar nga deponia.

Emisionet e liruarat në ajër dhe ujë nga deponia shpeshherë të panjohura në mungesë të monitorimit të vazhdueshëm, janë një nga shkaktarët e këtij ndikimi. Kur dihet fakti se në Deponitë Sanitare në Kosovë deponohen lloje të ndryshme të mbeturinave si minerale, metale, plastikë, letër, mbeturina të rrezikshme, qelq, dru, mbeturina të biodegradueshme etj, kjo e rrit edhe më shumë mundësinë e ndikimit negativ në mjedis.

Mbeturinat dhe kimikatet mbeturinë janë shpeshherë pikënisje edhe për paraqitjen e sëmundjeve dhe epidemive.

13. Konkluzionet dhe rekomandimet

13.1 Konkluzionet

- Korniza ligjore dhe nën ligjore për mbeturina dhe kemikate është e kënaqshme
- Strategjitë dhe Planet për menaxhimin e mbeturinave në nivel qendror dhe lokal janë në proces të hartimit dhe miratimit.
- Sistemi për administrimin e mbeturinave nuk është efikas dhe ka ngecje në shumë çështje;
- Në kuadër të përbërjes së përgjithshme të mbeturinave komunale dominojnë mbeturinat organike (të biodegradueshme).
- Mesatarja ditore e mbeturinave komunale për kokë banori në Kosovë është 0.9 kg.
- Në gjenerimin e mbeturinave industriale dominojnë industritë ushqimore dhe ato minerare.
- Gjendja në deponitë sanitare nuk është e mirë;
- Është identifikuar numër i madh i deponive ilegale;
- Ka mungesë të sistemit të monitorimit të gjendjes së mbeturinave;
- Mungesë të mekanizmave efikas për ndarjen dhe seleksionimin e mbeturinave;
- Mungesë e projekteve për riciklimin e mbeturinave,
- Raste të rralla të trajtimit dhe ripërdorimit të mbeturinave dhe kemikateve;
- Ka investime në sektorin e mbeturinave por nevojat për investime është ende e domosdoshme;
- Inkasim i ulët për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave;
- Bashkëpunim jo i mjaftueshëm në mes të institucioneve.

13.2 Rekomandimet

- Fuqizimi i institucioneve qendrore, lokale dhe kompanive për menaxhimin e mbeturinave;
- Rritja e bashkëpunimit ndër institucional në sektorin e mbeturinave,
- Kompletimi i bazës ligjore dhe zbatimi efikas i ligjeve në sektorin e mbeturinave dhe atë të kimikateve,
- Miratimi i Strategjive dhe Planeve për menaxhimin e mbeturinave në nivel qendror dhe lokal.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve, planeve dhe programeve për riciklimin, trajtimit dhe ripërdorimin e mbeturinave;
- Vetëdijesimi i popullatës lidhur me hedhjen e mbeturinave në vende adekuate dhe për kryerjen e obligimeve ndaj kompanive shërbyese;
- Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në deponi ilegale;
- Hartimi i programeve për zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Zhvillimi i Sistemit Informativ për mbeturina dhe hartogrfimi i të dhënave.

14. Referencat dhe Burimet

- Anketa e mbeturinave industriale 2010, ASK
- Anketa e mbeturinave komaunale 2009, 2010 dhe 2011, ASK
- Disa fakte për mjedisin, ESK 2009
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës-KDMK
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Produkte Biocide
- Ligjit për Kimikate Nr. 02/L-116
- Planet Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave- Prishtinë, Han i Elezit, Viti dhe Prizren.
- Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017
- Raporti, Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AMMK
- Raporti, Gjendja e mjedisit të Kosovës 2008-2010, AMMK
- Raporti, Hotspotet mjedisore në Kosovë, AMMK 2011
- Rezultatet e regjistrimit të popullsisë - ASK 2011.
- Statistikat vitale të kohës më të re, ASK. Prishtinë, 2004
- Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022
- Zyra Rregullatore për Ujësjllës dhe kanalizim, ZRRUK 2010.

15. Shtojcat

15.1 SHKURTESAT

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CLP	Klasifikimi etiketimi dhe paketimi i kimikateve të rrezikshme
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë për sundim të ligjit
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së
JICA	Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtarë
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat Paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë
KK	Kuvendi Komunal
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KRM	Kompani Regjionale e Mbeturinave
LST	Lista teknike e sigurisë nga kimikatet
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PCB	Poliklorure e Bifenileve
PCT	Polikloruret e Trifenileve
PET	Polietilen Tereftalati
PIM	Parku Industrial i Mitrovicës
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	Planet Lokale të Veprimit në Mjedis
PMB	Produkte Kimike për Mbrojtjen e Bimëve
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës

SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtarë
TAIEX	Asistenca Teknike për Shkëmbim të Informacionit
TC	Termocentral
TCA	Termocentrali A
TCB	Termocentrali B
UA	Udhëzim Administrativ
ZRRUK	Zyra Rregullator për Ujësjellës dhe Kanalizim

15.2 Indeksi i tabelave

Tabela 1.	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2009 të shprehura në ton
Tabela 2.	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2010 të shprehura në ton
Tabela 3.	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2011 të shprehura në ton
Tabela 4.	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2012 të shprehura në ton
Tabela 5.	Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2013 të shprehura në ton
Tabela 6	Sasia mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë për banorë (kg/vit dhe kg/ditë) për 2008- 2012
Tabela 7:	Përqindja (%) e mbeturinave sipas llojeve në Prishtinë, Prizren, Viti dhe Han i Elezit
Tabela 8:	Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me shtatë ose më shumë punëtorë
Tabela 9:	Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me më pak se shtatë punëtorë
Tabela 10:	Sasia e mbeturinave të gjeneruara, të mbeturinave të rrezikshme dhe të trajtuara
Tabela 11:	Sasia e mbeturinave spitalore në qendrat spitalore
Tabela 12:	Lloji dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme sipas lokacionit dhe komunave
Tabela 13:	Kompanitë të cilat kanë aplikuar në MMPH për leje importi për kimikate të rrezikshme dhe biocide
Tabela 14:	Lista e kimikateve të lejuara për import gjatë vitit 2012
Tabela 15:	Lista e produkteve biocide të notifikuara dhe të lejuara për import gjatë vitit 2012
Tabela 16:	Vend deponimet me mbeturinat e kimikateve industriale
Tabela 17:	Hot-spotet mjedisore sipas lokacioneve, aktivitetit, sipërfaqes dhe burimeve potenciale të ndotjes
Tabela 18:	Lista e operatorëve të licencuar që merren me mbledhjen, transportimin dhe riciklimin e mbeturinave
Tabela 19:	Llojet dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme të eksportuara për trajtim
Tabela 20:	Disa nga projektet e realizuara në sektorin e mbeturinave 2009-2012 në Euro

15.3 Indeksi i figurave

- Figura 1: Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare sipas viteve
- Figura 2: Sasia e grumbullimit të mbeturinave sipas regjioneve 2009-2013
- Figura 3: Përqindja (%) e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit në nivel të Kosovës
- Figura 4: Përqindja (%) e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit ne Prishtine dhe regjion
- Figura 5: Përqindja (%) e mbeturinave sipas mënyrës se grumbullimit sipas regjioneve tjera te Kosovës
- Figura 6: Përqindja (%) e mbeturinave sipas llojit 2012
- Figura 7: Përqindja (%) e mbeturinave sipas llojeve në Kosovë 2008 (%)
- Figura 8: Përqindja (%) e mbeturinave industriale të rrezikshme dhe jo të rrezikshme
- Figura 9: Harta e deponive ilegale
- Figura 10: Etiketimi i substancave të rrezikshme
- Figura 11: Forma e listës teknike të sigurisë për kimikate
- Figura 12: Simbolet e rrezikut (forma e vjetër)
- Figura 13: Piktogramet e rrezikut (forma e re)
- Figura 14: Harta e shpërndarjes së lokacioneve të hotspotëve në Kosovë

Raporti për mbeturinat dhe kimikatet
është përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Përgatitja e Raportit është realizuar nga ekspertët e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në bashkëpunim me ekspertët e Departamentit të Mjedisit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe ekspertë nga institucionet tjera relevante.

Në përgatitjen e këtij Raporti morën pjesë:

Tafë Veselaj- AMMK
Mimoza Hyseni Spahiu- AMMK
Afrim Berisha - AMMK
Sami Behrami- AMMK
Ibrahim Balaj - DMM/MMPH
Florije Tahiri - DMM/MMPH
Violeta Lajqi Makolli – DMM/MMPH
Adriana Pllana - AMMK
Përparim Gashi - AMMK

Raporti shpërndahet falas.
Versioni elektronik i raportit mundë të shkarkohet edhe në www.ammk-rks.net

Adresa e AMMK-së:
Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04
Tel. +381 38 200 33 228 , email: kepa@rks-gov.net
www.ammk-rks.net

Prishtinë, 2014

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

628.54(496.51)(047)

Raport për Mbeturinat dhe Kimikatet / [Përgatiten Tafë Veselaj...et al.]. – Prishtinë : Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2014. - 62 f. ; 29 cm.

Parathënie : f. 7. – Referncat dhe burimet : f. 60. - Indeksi i figurave : f. 63


1.Veselaj,Tafë

ISBN 978-9951-638-04-3

ISBN 978-9951-638-04-3



15.4 Harta e deponive ilegale



ISBN 978-9951-638-04-3



9 789951 638043